



SKENARËT E  
**'FINALES  
SË MADHE'**  
NDËRMJET  
**KOSOVËS DHE SERBISË**

Prill 2018

Mbështetur nga:



Norwegian Embassy

# SKENARËT E 'FINALES SË MADHE' NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Ky studim është mbështetur nga:



Norwegian Embassy

**Deklaratë mohimi:** Pikëpamjet dhe analiza në këtë hulumtim janë vetëm të RIDEA-s dhe BPRG-së dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

**Autorët:** Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA) & Grupi për Hulumtim të Politikave në Ballkan (BPRG)

\*Autorët janë mirënjohës të gjithë të intervistuarve dhe pjesëmarrësve të punëtorive për kontributin e tyre të paçmuar për qëllimet e këtij studimi. Çdo gabim ose gabim i mundshëm është i autorëve.

Prill 2018

## Tabela e Përmbajtjes

Lista e Shkurtesave .....	i
Përmbledhja Ekzekutive.....	ii
<b>1. Hyrje .....</b>	<b>1</b>
<b>2. Metodologjia dhe struktura .....</b>	<b>2</b>
<b>3. Çfarë ka arritur Kosova përmes dialogut të Brukselit deri më tani? .....</b>	<b>3</b>
3.1. Ndikimi i dialogut në integrimin e komuniteteve.....	6
3.2. Ndikimi i dialogut në zhvillimin ekonomik.....	8
3.3. Ndikimi i dialogut në integrimin Euro-Atlantik të Kosovës dhe pjesëmarrjes së plotë në sistemin/bashkësinë ndërkombëtare .....	10
3.4. Dialogu me pak fjalë.....	14
<b>4. Përgatitja për 'finalen e madhe': Çfarë lloj dialogu dhe formati? .....</b>	<b>15</b>
4.1. Cilat duhet të jenë objektivat e dialogut të ri?.....	17
4.2. Si të organizojmë dialogun e ri? Kush duhet të përfshihet? .....	19
<b>5. Diskutimi i skenarëve të mundshëm .....</b>	<b>22</b>
<b>5.1. Skenari I: Vazhdimi i status kuo-së .....</b>	<b>24</b>
<i>I (a). Jo-dialog (ndërprerje e dialogut) – qasja 'prit dhe shiko' .....</i>	<i>24</i>
<i>I (b). Vazhdimi i dialogut në formatin aktual .....</i>	<i>27</i>
<b>5.2. Skenari II: normalizimi i plotë i marrëdhënieve përmes një marrëveshje bilaterale/traktati .....</b>	<b>29</b>
<i>II(a) Normalizimin e plotë përmes njohjes reciproke që konfirmon shtetësinë e Kosovës .....</i>	<i>30</i>
<i>II(b) Kosova dhe Serbia nënshkruajnë një marrëveshje ligjore të obligueshme, me të cilën Serbia njihet sistemin politik dhe ligjor të Kosovës (duke përfshirë mundësinë për të fituar një ulëse në OKB), por pa njohje formale.....</i>	<i>34</i>
<b>5.3. Skenari III: Aranzhime të reja territoriale.....</b>	<b>39</b>
<b>6. Përfundimet.....</b>	<b>47</b>
<b>7. Rekomandime .....</b>	<b>52</b>
<b>Shtojca: Pyetësori .....</b>	<b>55</b>

## Lista e Shkurtesave

BE	Bashkimi Evropian
EEAS	Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FIFA	Asociacioni i Federatës Ndërkombëtare të Futbollit
KE	Komisioni Evropian
KON	Komiteti Olimpik Ndërkombëtar
KOSTT	Operatori i transmisionit, sistemit dhe tregut të energjisë në Kosovë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
SNS	Partia Progresive Serbe
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UEFA	Unioni i Shoqatave të Futbollit Evropian
UNESCO	Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara

## **Përmbledhja Ekzekutive**

Një dekadë që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe 7 vite të lehtësimit të dialogut nga BE në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk kanë menaxhuar që të sjellin normalizim të plotë të marrëdhënieve në mes të dy shteteve. Pavarësisht përparimeve të konsiderueshme të lidhura me integrimin e Serbëve lokal në sistemin Kosovar dhe qetësimin e tensioneve etnike, Kosova dhe Serbia deri në këtë ditë mbesin të bllokuara në kontestin e tyre politik dhe diplomatik në lidhje me shtetësinë e Kosovës dhe statusin e saj ndërkombëtar.

Megjithatë, pavarësisht arritjeve në dialogun aktual dhe dështimeve nga të dyja palët për të zbatuar disa nga dispozitat dhe marrëveshjet për të cilat janë dakorduar tashmë, pengesat politike dhe ngjarjet dhe faktorët tjerë gjeopolitikë, normalizimi i plotë i marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë mbetet ende lartë në agjendën e Bashkimit Evropian ashtu siç përcaktohet në strategjinë e fundit të zgjerimit të Bashkimit Evropian. Komisioni Evropian ka qenë i qartë dhe pa ekuivoke për faktin se 'një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjërishme e detyrueshme është urgjente dhe vendimtare në mënyrë që Serbia dhe Kosova të përparojnë në rrugën e tyre Evropiane.'

Në mënyrë që një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë të konkretizohet, ekzistojnë dy faktor kryesor që duhet të merren në konsideratë. Së pari, është bërë e qartë se pa një normalizim të plotë të marrëdhënieve Kosovë-Serbi nuk mund të ketë stabilitet të qëndrueshëm në rajon dhe se asnjëri shtet nuk do të jetë në pozitë për t'u anëtarësuar në BE. Përderisa strategjia e fundit e BE-së e bën të qartë se Serbia nuk do të jetë në gjendje t'i bashkohet BE-së pa normalizuar marrëdhëniet me Kosovën, megjithatë Serbisë i ofron një kornizë kohore të qartë dhe indikatorët e nevojshëm për anëtarësimin në BE deri në vitin 2025. Në anën tjetër, Kosova posedon një trajtim më të ndryshëm që konfirmon statusin e saj si një rast i veçantë në grupin e gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor (WB6), vetëm për shkak të mungesës së njohjes nga 5 shtetet anëtare të BE-së.

Aspekti i dytë i rëndësishëm lidhet me dinamikën e brendshme të Kosovës dhe detyrat e shtëpisë. Kosova tashmë ka humbur kohë të çmuar në një dialog pa qëllime dhe afate të qarta që përfundimisht kanë prodhuar rezultate të përziera në terren. Prandaj, nuk mund

të ja lejojë vetëvetës të kalojë një dekadë tjetër që të negociojë çështjet e saj të brendshme dhe të shpenzojë energji në një proces që tashmë duket se ka humbur besimin e publikut, siç indikohet edhe nga intervistat e kryera për këtë studim. Qartësisht, Kosova nuk ka kohë për të humbur. Kosova duhet të mobilizohet institucionalisht dhe politikisht për të nxitur një marrëveshje përfundimtare që do të mundësonte mbylljen e kapitullit të konfliktit me Serbinë dhe kështu të zhvendos fokusin e saj në reformat e brendshme dhe konsolidimin e institucioneve të saj si një mjet për të përparuar në rrugën e saj të integritit në BE.

Janë disa skenare të ndryshme në lidhje me rezultatin e procesit të ardhshëm. Skenari i parë i mundshëm është vazhdimi i status kuo-së. Kjo mund të manifestohet në versionin 'prit dhe shiko' (ndërprerje e dialogut). Në një mënyrë alternative, kjo mund të shprehet ngjashëm me procesin e deritanishëm, që do të përfshinte negociata politike dhe teknike në aspekte të ndara, pa një kornizë të përgjithshme, dhe qëllime dhe afate të përcaktuara qartë. Pasi që status kuo-ja nuk është e qëndrueshme dhe veçanërisht Kosova nuk përfiton prej saj, nga të intervistuarit del se negociimi në mungesë të përfshirjes më të fuqishme të BE-së dhe një marrëveshje ligjërishme e detyrueshme nuk është zgjidhje.

Skenari i dytë përfshin nënshkrimin e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse mbi normalizimin e plotë të marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Verzioni i parë i këtij skenari, i cili është përkrahur nga pjesa më e madhe e të intervistuarve, do të rezultonte në njohje reciproke. Një verzion më realist në këtë skenar, megjithatë, përfshin nënshkrimin e një marrëveshjeje ligjërishme të detyrueshme në të cilën Serbia pranon shtetësinë e Kosovës, duke përfshirë të drejtën e saj për t'iu bashkuar organizatave ndërkombëtare (OKB, në rradhë të parë), por pa njohur formalisht pavarësinë e saj. Kjo në masë të madhe do të varet nga aftësia e BE-së për të ushtruar presion në të dy palët dhe të ofroj shpërblime në formën e udhërrëfyesve konkret dhe afateve kohore precize për anëtarësimin në BE në këmbim të bashkëpunimit dhe kompromiseve të tyre.

Skenari i tretë parasheh normalizimin e plotë, duke përfshirë njohjen reciproke, përmes ri-rregullimit kufitar. Përderisa kjo alternativë gëzon më shumë simpati në Beograd dhe në masë më të vogël në Prishtinë, përmban disa rreziqe dhe të panjohura, duke përfshirë mundësinë për të destabilizur tërë rajonin. Një marrëveshje e tillë e ri-rregullimit kufitar

(shkëmbimit të territoreve) është e mundur vetëm atëherë kur të dy shtetet kanë njohur njëra-tjetrën. Megjithëse ky opsion është kundërshtuar nga shumica e të intervistuarve, do të mund të bëhet më atraktiv nëse zgjidhjet e tjera do të provohen si të pamundura.

Sidoqoftë, çfarëdo marrëveshje që të ketë sukses dhe të hap rrugën për normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes të dy palëve, stabilizimin e rajonit dhe kalimin më të shpejt drejt anëtarësimit në BE, është e domosdoshme që marrëveshja të ketë përkrahje të plotë nga të gjitha palët, të përmbaj garancione të qarta nga BE-ja, mos të jetë e dykuptimshme dhe, e fundit por jo më pak e rëndësishme, procesi të jetë politikisht dhe shoqërisht sa më gjithëpërfshirës dhe transparent.

## 1. Hyrje

Pothuajse shtatë vite që nga fillimi i dialogut Kosovë-Serbi dhe pothuajse 5 vite që nga nënshkrimi i “Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Drejtojnë Normalizimin e Marrëdhënieve”, të dhënat për ndërmjetësimin e BE-së në dialog janë të përziera dhe kontestuar. Dokumenti i prillit 2013 që përcaktoi parametrat për përfshirjen e Kosovës veriore në kornizën ligjore të Prishtinës, duke rritur kështu nivelin e të drejtave për komunitatet e dominuara nga Serbët (veçanërisht ato të cilat gjenden në veri) dhe duke ofruar mundësi për një bashkëpunim më të ngushtë përmes Asocacionit/Komunitetit të komunave me shumicë Serbe në Kosovë (në vijim Asocacioni/Komuniteti)<sup>1</sup>, si dhe marrëveshjet e tjera që kanë pasuar, kanë qenë vështirë të zbatueshme dhe politikisht të diskutueshme. Pëkundër arritjes së një progresi të konsiderueshëm, kryesisht sa i përket menaxhimit të kufinjve dhe lirisë së udhëtimit, integritetit të policisë, organizimit të zgjedhjeve në pjesën veriore të vendit, telekomunikacionit dhe gjyqësorit, të dy vendet kanë dështuar zbatimin e plotë të marrëveshjeve të nënshkruara.

Megjithatë, përkundër dështimeve për të zbatuar marrëveshjet që kanë qenë të pajtueshme mes dy palëve, pengesave politike dhe faktorëve dhe ngjarjeve tjera gjeopolitike, normalizimi i marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë mbetet akoma lartë në agjendën e BE-së, me BE-në që pritet të shtyjë procesin në një marrëveshje të re/përfundimtare në mes dy shteteve që do të sigurojnë një normalizim të plotë të marrëdhënieve. Në korrik të vitit 2017, pas një takimi jo zyrtar me Presidentët, Aleksander Vuçiç të Serbisë dhe Hashim Thaçi të Kosovës, në Bruksel, Federica Mogherini, Përfaqësuese e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë/ Zëvendës-Prezidentet e Komisionit Evropian, bëri të ditur fillimin e një ‘faze të re’ në dialog.

Sipas njoftimit zyrtar për shtyp të BE-së, “Ata [të dy presidentët] janë pajtuar që të punojnë për fillimin e një faze të re të dialogut në mes Beogradit dhe Prishtinës për normalizimin e

---

<sup>1</sup> Asocacioni/ Bashkësia e komunave me shumicë Serbe në Kosovë- parimet e përgjithshme/elementet kryesore. [http://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/150825\\_02\\_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/150825_02_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements_en.pdf)



marrëdhënies dhe pajtimit, dhe vendosën që ekipet respektive do të fillojnë të punojnë sa i përket përgatitjeve. Ata gjithashtu theksuan rëndësinë e zbatimit të marrëveshjeve të arritura në dialog pa vonesë”.<sup>2</sup> Ndërkohë që zyrtarët e BE-së gjithnjë e më shumë flasin për këtë marrëveshje të re gjithëpërfshirëse dhe të detyrueshme ligjore, formati, parametrat dhe afatet kohore mbesin ende për t’u caktuar.<sup>3</sup>

Duke marrë parasysh procesin e vazhdueshëm dhe përgatitjet për fazën e re/përfundimtare të dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë, ky studim synon të përvijoj një numër të zgjidhjeve të mundshme, të diskutojë për arsyeshmërinë e tyre, implikimet më të gjera dhe, më e rëndësishmja, gjasat e tyre për të sjell një normalizim të plotë të marrëdhënies ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Rrjedhimisht, ky studim përmban një analizë të detajuar të skenarëve kryesore të mundshme për një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe një listë rekomandimesh konkrete për politik-bërësit para fillimit të fazës përfundimtare të dialogut. Studimi përqendrohet në tre skenare kryesore të mundshme: a) vazhdimi i *status quo-së*; b) normalizimi i plotë përmes një traktati/marrëveshje ligjërish të detyrueshme; dhe c) aranzhime të reja territoriale në parimin e reciprocitetit dhe proporcionalitetit të plotë (veriu i Kosovës për Luginën e Preshevës). Përderisa këto janë skenarët kryesorë të ekzaminuar në këtë studim, një numër shtesë i nën-variantëve dhe opsioneve të mundshme do të diskutohen, brenda këtyre tre skenarëve.

## 2. Metodologjia dhe struktura

Ky studim që bazohet në burime primare (intervista, punëtori dhe tryeza të rrumbullakëta). Në mënyrë që të diskutohen këto skenare, duke përfshirë mundësitë dhe implikimet e mundshme, studimi bazohet në burime primare shumë të pasura dhe të ndryshme. Gjegjesisht, janë realizuar rreth njëqind intervista me politik-bërësit, ekspertët, aktivistët e shoqërisë civile dhe diplomatët si dhe dy punëtori me aktivistë të shoqërisë

---

<sup>2</sup> UAE (2017) ‘Federica Mogherini takoi Presidentin Vučić të Serbisë dhe Thaçi të Kosovës,’ Njoftim për shtyp, 3 korrik. [https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage\\_fr/29156/Federica%20Mogherini%20meets%20with%20President%20Vučić%20of%20Serbia%20and%20Thaci%20of%20Kosovo](https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage_fr/29156/Federica%20Mogherini%20meets%20with%20President%20Vučić%20of%20Serbia%20and%20Thaci%20of%20Kosovo)

<sup>3</sup> Intervista 65: Zyrtar i BE-së në Bruksel (07/12/2017).

civile, studiues të fushës dhe ekspertë. Këto burime plotësohen edhe nga artikuj tjerë të mediave, studime dhe raporte të ndryshme, si dhe diskutime dhe propozime për marrëdhëniet mes dy vendeve, dhe të ardhmën e marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë.

Edhe pse, herë pas herë studimi përmban diskutime analitike (vetëm në rastet kur nuk bëhen referenca eksplicite për opinionet e të intervistuarve në formë të citimeve të drejtpërdrejta, parafrazimeve ose përmbledhjeve), qëllimi kryesor është të pasqyroj pa ndërhyrje mendimet dhe pozicionet e të intervistuarve. Për këtë qëllim, aty ku është e mundur, raporti do t'i kategorizoj në grupe të intervistuarit varësisht prej qëndrimeve specifike të të intervistuarve dhe pozicionet në çështje specifike, pozicionin ose skenarin. Fatkeqësisht, duke pasur parasysh sasinë e madhe të tekstit dhe informacionit të grumbulluar përmes intervistave dhe punëtorive, dhe fakti që shumë përgjigje përputhen ose ndeshen, në disa raste, do të jetë e pamundur të ofrohen inpute nga secila intervistë individuale.

Studimi është i ndarë në katër pjesë kryesore. Pjesa e parë përmban një analizë të arritjeve dhe dështimeve të dialogut deri tani dhe ndikimin e dialogut në aspekte të ndryshme në Kosovë (bie fjala., pozicionin rajonal dhe ndërkombëtar të Kosovës, zhvillimin ekonomik, integrimin e komuniteteve, etj). Pjesa e dytë diskuton përgatitjet për fazën e re të dialogut dhe parakushtet përfundimtare për një proces të suksesshëm të negociatave dhe një marrëveshje që sjell stabilitet dhe normalizim të plotë të marrëdhënieve. Pjesa e tretë shqyrton tre skenarët kryesor dhe modalitetet e ndryshme brenda tyre. Pjesa e fundit ofron një pasqyrë të skenarëve kryesor dhe një listë të rekomandimeve për institucionet e Kosovës që do të merren parasysh gjatë fazës së ardhshme/përfundimtare të dialogut.

### **3. Çfarë ka arritur Kosova përmes dialogut të Brukselit deri më tani?**

Dialogu Kosovë-Serbi, i cili përfshinte çështje teknike dhe politike, filloi më 8 mars 2011 në Bruksel. Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja ishte paraparë si një mekanizëm për

menaxhimin e konfliktit për (i) të promovuar bashkëpunimin në mes dy palëve, (ii) ndihmuar në arritjen e progresit drejt integritimit Evropian, dhe (iii) të ketë efekt praktik pozitiv në jetën e njerëzve në Kosovë dhe në Serbi.<sup>4</sup> Sipas fjalëve të një zyrtari të lartë të BE-së në Bruksel: “Roli kryesor është ndërtimi i marrëdhënieve bilaterale (dypalëshe) në mes Kosovës dhe Serbisë.... Pra, përmes këtij dialogu qëllimi ishte të fillonte vendosja e marrëdhënieve bilaterale (dypalëshe) dhe të fillonte mundësia e adresimit të çështjeve që kanë ndikim në jetën e përditshme të njerëzve në të dy anët”.<sup>5</sup>

Në shumë mënyra, kjo është vazhdimësi e dialogut të Vjenës në vitet 2005-2007 që rezultoi me Propozimin e Ahtisaarit, në bazë të së cilit Kosova shpalli pavarësinë dhe themeloi kornizën e saj institucionale. Sidoqoftë, duke qenë se Serbia nuk e pranoi Propozimin e Ahtisaarit, ajo ka shtyrë për zgjidhje që shkojnë përtej propozimit të Ahtisaarit ose kornizës aktuale institucionale dhe ligjore të Kosovës.

Deri tani, të dy qeveritë kanë arritur më shumë se tridhjetë e tre<sup>6</sup> marrëveshje të ndryshme që mbulojnë një gamë të gjerë çështjesh. Megjithatë, sipas raporteve<sup>7</sup> periodike të Qeverisë së Kosovës dhe atyre nga Mbikqyrja Qytetare e Zbatimit të Marrëshjeve Kosovë-Serbi,<sup>8</sup> rreth një e treta e marrëveshjeve të nënshkuara janë zbatuar plotësisht deri tani. Marrëveshjet kryesore që nuk janë zbatuar akoma përfshijnë energjinë (operimin e pavarur të KOSTT), rivitalizimin e urës së Mitrovicës dhe Asociacionin e komunave me shumicë Serbe në Kosovë.

Marrëveshja/Viti	Statusi
Ura e Mitrovices (2011, 2015, 2017)	Pjesërisht e përfunduar
Regjistri Civil (2011)	E përfunduar
Liria e lëvizjes (2011)	Pjesërisht e përfunduar
Kadastrri (2011)	E papërfunduar
Vulat doganore (2011)	E përfunduar

<sup>4</sup> David. L. Philips (2017) Rishikimi i zbatimit të dialogut Kosovë- Serbi (New York: Universiteti i Kolumbisë, Instituti për Studimin e të Drejtave të Njeriut), 7. [http://www.humanrightscolumbia.org/sites/default/files/2017\\_09\\_05\\_kosovo-serbia\\_report.pdf](http://www.humanrightscolumbia.org/sites/default/files/2017_09_05_kosovo-serbia_report.pdf)

<sup>5</sup> Intervista 65.

<sup>6</sup> Intervista 46: Ish- zyrtar i lartë i Kosovës në dialogun e ndërmjetësuar nga BE në mes Prishtinës dhe Beogradit. (30/11/2017).

<sup>7</sup> Ministria për Dialog (2016) *Marrëveshjet e Brukselit: Gjendja e Zbatimit* (Raporti i derguar në Bashkimin Evropian/Shërbimi Evropian i Veprimt të Jashtëm nga Qeveria e Republikës së Kosovës). [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo\\_Report\\_on\\_State\\_of\\_Play\\_in\\_implementation\\_of\\_the\\_Brussels\\_Agreements\\_25\\_November\\_2016.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo_Report_on_State_of_Play_in_implementation_of_the_Brussels_Agreements_25_November_2016.pdf)

<sup>8</sup> 'BIG DEAL: Split Asunder' (2015). <http://prishtinainsight.com/wp-content/uploads/2016/02/ENG-publikim-BIGDEAL-3-FINAL-1.pdf>

Pranimi reciprok i diplomave (2011)	E papërfunduar
Menaxhimi i Integruar i Kufirit (2011, 2015)	Pjesërisht e përfunduar
Përfaqësimi dhe bashkëpunimi rajonal (2012)	Pjesërisht e përfunduar
Telekomunikacioni (2013, 2015)	E përfunduar
Energjia (2013, 2015)	E papërfunduar
Themelimi i katër komunave (2013)	E përfunduar
Asocacioni/Bashkësia e komunave Serbe (2015)	E papërfunduar
Policia (2013)	E përfunduar
Siguria (shpërbërja e 'Mbrojtjes Civile') (2015)	Pjesërisht e përfunduar
Gjyqësori (2015, 2017)	E përfunduar

*Tabela 1. Marrëveshjet kryesore të Brukselit dhe statusi i tyre aktual i zbatimit.*

*Kjo tabelë është përpiluar mbi bazën e informacionit të grumbulluar nga raportet periodike të Qeverisë së Kosovës dhe nga raportet e 'Marrëveshjes së Madhe'*

Shumica e të intervistuarve që theksojnë ndikimin pozitiv të dialogut nxjerrin në pah përfitimet e Kosovës nga marrëveshja për IBM dhe marrëveshjes për doganat, regjistrin civil, integritet të policisë dhe gjyqësorit, telekomunikacionit, si dhe marrëveshjet për themelimin e komunave të reja dhe organizimin e zgjedhjeve në pjesën veriore të Kosovës.<sup>9</sup> Sipas një ish-Zyrtari të lartë të Kosovës për Dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja në mes të Prishtinës dhe Beogradit, Kosova gjithashtu “fitoi në agjendën evropiane, nënshkroi MSA-në duke e formalizuar procesin e integritet në BE, krijoi marrëdhënie të veçanta me NATO-n, dhe mori anëtarësimin në të gjitha organizatat relevante rajonale si dhe kodin e saj shtetëror 383 të dedikuar nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit.”<sup>10</sup>

Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve e vënë në dyshim ndikimin e dialogut në procesin e konsolidimit të shtetit për Kosovën. Po ashtu, dialogu nuk ka arritur të prodhojë ose ka prodhuar ndikim të vogël në marrëdhëniet dypalëshe midis qeverive të

<sup>9</sup> Intervista 1: Zyrtar në zyrën e Presidentit të Kosovës (09/11/2017); Intervista 63: Deputet i Kuvendit të Kosovës, LDK (06/12/2017); Intervista 67: Zyrtar i lartë në LDK dhe anëtar i grupit negociator të Kosovës gjatë negociatave të Vjenës për statusin e ardhshëm të Kosovës (2005-2007) (07/12/2017); Intervista 49: Këshilltar i Presidentit të Kosovës (01/12/2017); Intervista 46.

<sup>10</sup> Intervista 46.

Kosovës dhe Serbisë, përveç krijimit të zyrave ndërlidhëse. Serbia ka arritur të shmang bashkëveprimin me qeverinë e Kosovës jashtë takimeve të Brukselit. Tensionet e kundërta janë rritur në mënyrë periodike midis dy qeverive (p.sh., nisja e trenit 'nacionalist' nga Serbia në Kosovë, arrestimi i ish-kryeministrit Ramush Haradinaj në Francë mbi bazën e flet-arrestit Serb, etj.).

### 3.1. Ndikimi i dialogut në integrimin e komuniteteve

Përveç rëndësisë dhe rolit të marrëveshjeve të Brukselit në aftësimin e Kosovës që të krijojë për herë të parë një lloj (të kufizuar) të pranisë institucionale dhe kontrolli në veri të Kosovës, të intervistuarit gjithashtu theksojnë rëndësinë e dialogut në *përmirësimin e përgjithshëm të situatës ndër-etnike* në Kosovë. Sipas njërit nga ish-zëvendësministrat e Punëve të Jashtme, "brenda vendit, ndoshta efekti më i rëndësishëm ishte se dhuna ndër-etnike dhe konfrontimi ndër-etnik ka rënë dukshëm; në vitin 2016 në veri ishin vetëm më pak se 10 incidente etnike, dhe nëse e krahasoni atë me disa vite më parë, keni pasur hedhje gurësh, djegie, barrikada etj."<sup>11</sup> Gjithashtu, të tjerë të intervistuar theksojnë këtë: Efekti i dialogut ka qenë pozitiv në kuptimin e integritetit të strukturave paralele në veri, në kuadër të sistemit të Kosovës.<sup>12</sup> Gjithashtu, ka patur efekt pozitiv në kuptimin e krijimit të një mjedisi më të favorshëm për lëvizje të njerëzve dhe mallrave, dhe në përgjithësi, Kosova ka qenë relativisht stabile për shkak të dialogut.<sup>13</sup>

Edhe tjerë persona të intervistuar për këtë studim theksojnë arritjet e dialogut në përmirësimin e përgjithshëm të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë.<sup>14</sup> Sipas një përfaqësuesi të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, "dialogu është çelësi i mbijetesës sonë dhe përmirësimit të marrëdhënieve të njerëzve që jetojnë në këtë hapësirë."<sup>15</sup> Organizimi i zgjedhjeve lokale dhe parlamentare në veri të Kosovës për herë të parë që nga pavarësia e Kosovës konsiderohet gjithashtu si një sukses i madh.<sup>16</sup>

---

<sup>11</sup> Intervista 39: Ish- zëvendësministër i Punëve të Jashtme (Prishtinë, 24/11/2017).

<sup>12</sup> Intervista 22: Aktivist i shoqërisë civile (Prishtinë, 21/11/2017).

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Intervista 39; Intervista 32: Përfaqësues i lartë në AKTIV (Prishtinë, 23/11/2017).

<sup>15</sup> Intervista 96: Përfaqësues i lartë i Kishës Ortodokse/Ipeshkvisë në Kosovë (28/12/2017).

<sup>16</sup> Intervista 17: Përfaqësues i lartë në Qendrën e Kërkimit për Siguri dhe Politikë (SPRC) (Prishtinë, 16/11/2017); Intervista 39.

Një ish-Zyrtar i lartë i Kosovës për Dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja në mes të Prishtinës dhe Beogradit argumenton se “Republika e Kosovës është e vendosur për të ardhmën e saj Euro-Atlantike, përkatësisht integrimin në BE, NATO, OKB dhe organizata tjera relevante ndërkombëtare, prandaj është në interesin tonë të jemi pjesë e dialogut të Brukselit, jo vetëm për shkak të sigurimit të së ardhmës sonë Euro-Atlantike, por gjithashtu për të kontribuar në forcimin e paqës dhe stabilitetit në rajon duke qenë se kemi pasur një të kaluar të trazuar”.<sup>17</sup>

Ndërsa pjesëmarrësit e dialogut nga pala Kosovare e mbrojnë atë duke argumentuar se i ka mundësuar Kosovës të integroj serbët vendor në sistemin politik, shumë figura opozitare dhe përfaqësues të shoqërisë civile janë skeptik për përfitimet e dialogut.<sup>18</sup> Një numër i argumenteve në mbështetje të qëndrimit se dialogu nuk i ka sjellur përfitime Kosovës, është gjeneruar nga intervistat. Sipas deputetëve opozitarë, Kosova nuk ka arritur asgjë përmes dialogut me Serbinë: I vetmi rezultat ka qenë progresi i Serbisë në agjendën e integritetit në BE.<sup>19</sup>

Shumë theksojnë faktin se shumë marrëveshje mbetën vetëm në letër dhe nuk janë zbatuar ose nuk kanë sjellur ndonjë rezultat. Për shembull, edhe pse Kosova dhe Serbia shkëmbyen zyrtar ndërlidhës shumë vite më parë, ato nuk prodhuan ndonjë efekt në lehtësimin e komunikimit të drejtpërdrejt midis Prishtinës dhe Beogradit.<sup>20</sup>

Gjithashtu, përfaqësuesit e komuniteteve serbe dhe të tjera jo-shqiptare kanë kritikuar e tyre për dialogun aktual. Sipas një ish-deputeti Serb, “përderisa ka pasur sukses në rritje të shtrirjes së sovranitetit të Kosovës në pjesën veriore të territorit dhe fillimin e integritetit të serbëve nga ajo pjesë në sistemin Kosovë, fatkeqësisht, kemi vënë re trende negative në integrimin e Serbëve nga pjesë të tjera të Kosovës”.<sup>21</sup> Gjithashtu, sipas një Deputeti Boshnjak në Kuvendin e Kosovës,<sup>22</sup> dialogu nuk solli shumë efekte pozitive në teren.

---

<sup>17</sup> Intervista 46.

<sup>18</sup> Intervista 1; Intervista 25: Deputet i Kuvendit të Kosovës, LVV (21/11/2017); Intervista 23: Deputet i Kuvendit të Kosovës (21/11/2017); Intervista 37: Gazetar Senior në Koha Ditore (23/11/2017); Intervista 11: Deputet i Kuvendit të Kosovës, AAK (Prishtinë, 14/11/2017).

<sup>19</sup> Intervista 34: Deputet i Kuvendit të Kosovës, LVV (Prishtinë, 23/11/2017); Intervista 41: Deputet i Kuvendit të Kosovës, LVV (Prishtinë, 27/11/2017); Intervista 25.

<sup>20</sup> Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga RIDEA dhe BPRG në Prishtinë (16/01/2018).

<sup>21</sup> Intervista 57: Ish-Deputet i Kuvendit të Kosovës nga komuniteti Serb në Kosovë (05/12/2017).

<sup>22</sup> Intervista 9: Deputet i Kuvendit të Kosovës, Koalicioni VAKAT (6+) (Prishtinë, 14/11/2017).

Në përgjithësi, një në dy të të intervistuarve<sup>23</sup> mendojnë se dialogu ka pasur efekt pozitiv në integrimin e komuniteteve në Kosovë, një në pesë nga të intervistuarit<sup>24</sup> mendojnë se ka pasur impakt negativ në integrimin e komuniteteve. Në anën tjetër, një në katër të të intervistuarve<sup>25</sup> nuk ka identifikuar ndonjë efekt pozitiv apo negativ ose nuk i është përgjigjur pyetjes fare.

### 3.2. Ndikimi i dialogut në zhvillimin ekonomik

Shumë prej të intervistuarve kritikuan institucionet e Kosovës që kanë dështuar të përcaktojnë qëllimeve të qarta dhe afate kohore në fillimin e procesit<sup>26</sup> ose se “njerëzit e

<sup>23</sup> Intervista 59: Zyrtar i lartë në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (Prishtinë, 06/12/2017); Intervista 22; Intervista 36: Deputet i Kuvendit të Kosovës, PREBK (6+), (Prishtinë, 23/11/2017); Intervista 37; Intervista 83: Këshilltar i Presidentit të Kosovës (Prishtinë, 19/12/2017); Intervista 60: Përfaqësues i Qendrës Evropiane për çështje të minoriteteve në Kosovë (ECMI) (Prishtinë, 06/12/2017); Intervista 56: Anëtar i Akademisë të Arteve dhe Shkencave të Kosovës (ASHAK) (Prishtinë, 05/12/2017); Intervista 4: Zyrtar i lartë, Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës (Prishtinë, 13/11/2017); Intervista 97: Ish- Zyrtar i lartë Qeveritar i përfshirë në dialogun Prishtinë- Beograd (Prishtinë, 29/12/2017); Intervista 1; Intervista 15: Editor i lartë në Klan Kosova (Prishtinë, 16/11/2017); Intervista 12: Zyrtarë i lartë në Odën Ekonomike të Kosovës (Prishtinë, 15/11/2017); Intervista 81: Profesor në Fakultetin Juridik, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë, 18/12/2017); Intervista 21: Deputet i Kuvendit të Kosovës, NISMA (Prishtinë, 20/11/2017); Intervista 49; Intervista 17; Intervista 87: Profesor asistent në Fakultetin Juridik, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë, 21/12/2017); Intervista 30: Deputet i Kuvendit të Kosovës, PDAK, (6+), (Prishtinë, 23/11/2017); Intervista 90: Aktivist i Shoqërisë Civile nga komuniteti Serb në Kosovë (Prishtinë, 22/12/2017); Intervista 46; Intervista 79: Deputet i Kuvendit të Kosovës, PDK (Prishtinë, 18/12/2017); Intervista 98: Ligjërues i së Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane në Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë (UBT) (Prishtinë, 03/01/2018); Intervista 8: Profesor në Fakultetin Juridik, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë, 13/11/2017); Intervista 95: Profesor asistent i Ekonomisë në Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë (UBT) (Prishtinë, 27/12/2017); Intervista 19: Kryeredaktor/ Përfaqësues në Radio Televizionin 21 (RTV 21) (Prishtinë, 17/11/2017); Intervista 26: Ish- Zyrtar i lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Integrimi Evropiane (Prishtinë, 21/11/2017); Intervista 68: Ligjërues i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin Amerikan të Kosovës (AUK) (Prishtinë, 08/12/2017); Intervista 48: Përfaqësues i lartë në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) (Prishtinë, 30/11/2017); Intervista 72: Profesor asistent në Departamentin e Shkencave politike, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë, 12/12/2017); Intervista 64: Këshilltar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës (Prishtinë, 07/12/2017); Intervista 71: Përfaqësues i lartë nga komuniteti Serb, OJQ në Kosovën Veriore (Mitrovica Veriore, 11/12/2017); Intervista 24: Përfaqësues i lartë në Institutin Kosovar për Hulumtim të Politikave dhe Zhvillimit (KIPRED) (Prishtinë, 21/11/2017); Intervista 67; Intervista 40: Deputet i Kuvendit të Kosovës, PDK (Prishtinë, 27/11/2017); Intervista 13: Kryeredaktor në Radio Televizionin e Kosovës (RTK) (Prishtinë, 16/11/2017); Intervista 6: Kryeredaktor në Rrokum TV (Prishtinë, 13/11/2017); Intervista 86: Zyrtar i lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme (Prishtinë, 20/12/2017); Intervista 32; Intervista 7: Menaxher i përgjithshëm në ‘Shëndetësi për të gjithë’ (HFA), Aktivist i Shoqërisë Civile nga komuniteti RAE në Kosovë (Fushë Kosovë, 13/11/2017); Intervista 69: Deputet i Kuvendit të Kosovës, PDK (Prishtinë, 11/12/2017); Intervista 62: Deputet i Kuvendit të Kosovës, LDK (Prishtinë, 06/12/2017); Intervista 3: Përfaqësues i lartë në Qendrën për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (CRDP) (Prishtinë, 09/11/2017); Intervista 89: Ish- përfaqësues i Qeverisë së Kosovës në dialogun e ndërmjetësuar nga BE në mes Prishtinës dhe Beogradit (Prishtinë, 21/12/2017); Intervista 10: Ish- Zëvendës Ministër i Integrimi Evropiane & Aktivist i Shoqërisë Civile (Prishtinë, 14/11/2017); Intervista 76: Zyrtar i lartë në Bashkësinë Islame të Kosovës (Prishtinë, 14/12/2017); Intervista 20: Këshilltar në Ministrinë e Integrimi Evropiane të Kosovës (Prishtinë, 20/11/2017); Intervista 53: Ish- Zëvendës Ministër i Punëve të Brendshme (Prishtinë, 01/12/2017); Intervista 5: Analist politik/Publicist (Prishtinë, 13/11/2017); Intervista 50: Përfaqësues i lartë në Demokraci për Zhvillim (D4D) (Prishtinë, 01/12/2017); Intervista 82: Përfaqësuesi i Lartë i Këshillit për Qeverisje Gjithëpërfshirëse (CIG) (Prishtinë, 19/12/2017); Intervista 29: Deputet i Kuvendit të Kosovës, AAK (Prishtinë, 22/11/2017); Intervista 70: Përfaqësues i lartë në Demokraci + (Prishtinë, 11/12/2017); Intervista 18: Përfaqësues i lartë i partisë politike – Lëvizja për Bashkim – (LB) (Prishtinë, 16/11/2017); Intervista 73: Deputet i Kuvendit të Kosovës, PDK (Prishtinë, 12/12/2017); Intervista 42: Deputet i Kuvendit të Kosovës, PDK (Prishtinë, 29/11/2017).

<sup>24</sup> Intervista 55: Editor i lartë në Kohavision (Prishtinë, 04/12/2017); Intervista 11; Intervista 25; Intervista 27: Zyrtar i lartë në AAK & Anëtar i grupit negociues të Kosovës gjatë negociatave në Vjenë për statusin e ardhshëm të Kosovës (2005-2007) (Prishtinë, 22/11/2017); Intervista 45: Deputet i Kuvendit të Kosovës, LDK (Prishtinë, 30/11/2017); Intervista 43: Profesor i Ekonomisë në Universitetin Amerikan të Kosovës (AUK) (Prishtinë, 29/11/2017); Intervista 85: Përfaqësues i lartë në Institutin për Zhvillim të Politikave (INDEP) (Prishtinë, 20/12/2017); Intervista 52: Deputet i Kuvendit të Kosovës, LVV (Prishtinë, 01/12/2017); Intervista 91: Profesor në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë, 22/12/2017); Intervista 9; Intervista 41; Intervista 34; Intervista 33: Deputet i Kuvendit të Kosovës, NISMA (Prishtinë, 23/11/2017); Intervista 38: Deputet i Kuvendit të Kosovës, LVV (Prishtinë, 24/11/2017); Intervista 16: Deputet i Kuvendit të Kosovës, LVV (Prishtinë, 16/11/2017); Intervista 23; Intervista 31: Përfaqësues i lartë në Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur, (KFOS) (Prishtinë, 23/11/2017); Intervista 44: Profesor i Politikës Publike në Universitetin Amerikan në Kosovë (AUK) (Prishtinë, 29/11/2017); Intervista 65; Intervista 88: Aktivist i Shoqërisë Civile nga komuniteti Serb në Kosovë (Prishtinë, 21/12/2017); Intervista 93: Aktivist i Shoqërisë Civile nga komuniteti Serb në Kosove, NANSEN Mitrovica (Mitrovica Veriore, 22/12/2017).

<sup>25</sup> Intervista 47: Këshilltar politik i Kryeparlamentarit të Kosovës (Prishtinë, 30/11/2017); Intervista 28: Profesor asistent në Departamentin e Shkencave Politike, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë, 22/11/2017); Intervista 84: Ligjërues i Ekonomisë ndërkombëtare në Kolegjin Riinvest (Prishtinë, 20/12/2017); Intervista 2: Profesor i asociuar në Departamentin e Shkencave Politike, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë, 09/11/2017); Intervista 63; Intervista 78: Profesor i asociuar në Departamentin e Shkencave Politike, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë, 18/12/2017); Intervista 94: Përfaqësues i lartë i Kishës Katolike/Eparkisë në Kosovë (Prishtinë, 26/12/2017); Intervista 66: Deputet i Kuvendit të Kosovës, NDS (Prishtinë, 07/12/2017); Intervista 61: Ish-Zyrtar i Lartë i Kosovës (Prishtinë, 06/12/2017); Intervista 35: Deputet i Kuvendit të Kosovës, KDTP (6+), (Prishtinë, 23/11/2017); Intervista 100: Përfaqësues i lartë në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) (Prishtinë, 10/01/2018); Intervista 99: Aktivistë i Shoqërisë Civile dhe Analist politik (Prishtinë, 04/01/2018); Intervista 74: Zyrtar i lartë në NISMA & Anëtar i grupit negociues të Kosovës gjatë negociatave në Vjenë për statusin e ardhshëm të Kosovës (2005-2007) (Prishtinë, 12/12/2017); Intervista 51: Deputet i Kuvendit të Kosovës, LDK (Prishtinë, 01/12/2017); Intervista 80: Avokat & Ligjërues i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane në Universitetin e Mitrovicës ‘Isa Boletini’ (Mitrovicë, 18/12/2017); Intervista 14: Profesor në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Prishtinës (Prishtinë, 16/11/2017); Intervista 57; Intervista 75: Ish- Zyrtar i lartë në Kuvendin e Kosovës (Prishtinë, 13/12/2017); Intervista 39; Intervista 96; Intervista 92: Anëtar i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës (ASHAK) (Prishtinë, 26/12/2017); Intervista 54: Anëtar i grupit negociues të Kosovës gjatë negociatave në Vjenë për statusin e ardhshëm të Kosovës (Prishtinë, 01/12/2017).

<sup>26</sup> Intervista 11.



Kosovës nuk ndjenjë ndonjë përfitim nga dialogu.”<sup>27</sup> Në këtë aspekt, të intervistuarit kritikojnë mungesën e përfitimeve ekonomike nga procesi i dialogut dhe faktin se “zhvillimi ekonomik është diçka që lënë anash për një kohë të gjatë.”<sup>28</sup>

Sidoqoftë, sipas një ish-Zyrtari të lartë të Kosovës për Dialogun e ndërmjetësuar nga BE në mes të Prishtinës dhe Beogradit, përfitimet ekonomike janë të rëndësishme. Sipas këtij ish-zyrtari të lartë, përfitimet ekonomike së pari ndërlidhen me të hyrat nga doganat që mbledhen në Veri të Kosovës.<sup>29</sup> Në fakt, nga viti 2008-2013, qeveria e Kosovës nuk kishte kontroll mbi pikat doganore në veri dhe që kur marrëveshja për mbledhjen e të ardhurave nga dogana është arritur në vitin 2013, situata ka ndryshuar në mënyrë pozitive. Kështu, që atëherë, doganat e Kosovës kanë mbledhur më shumë se 13 milionë euro për 'Fondin e Zhvillimit të katër komunave veriore' nga të dyja pikat doganore në veri të Kosovës.<sup>30</sup> Po ashtu, Dogana e Kosovës ka zgjeruar autoritetin e plotë doganor në të dy pikat doganore në veri të Kosovës (Jarinjë dhe Bërnjak) për të mbledhur të hyra, detyrime doganore dhe TVSH.<sup>31</sup> Të tjerë të intervistuar, gjithashtu, theksojnë ndikimin pozitiv të marrëveshjes doganore,<sup>32</sup> si dhe atë në telekomunikacion<sup>33</sup> prej të cilave përfiton buxheti i Kosovës.

Megjithatë, në një shkallë më të gjerë, ndikimi ekonomik ishte mjaft i kufizuar, veçanërisht në drejtim të krijimit të një klime më të mirë për investimet e huaja. Siç thekson një i intervistuar, megjithëse “Kosova ka qenë relativisht e qëndrueshme për shkak të dialogut, gjithashtu nuk ka zgjidhur dhe eliminuar asnjë shqetësim që investitorët mund të kenë lidhur me statusin ligjor të vendit dhe disa prej tyre mund të kenë disa shqetësime në lidhje me këtë.”<sup>34</sup> Një aspekt tjetër negativ lidhet me ndërhyrjen e Serbisë në sistemin energjetik të Kosovës,<sup>35</sup> që i kushton vendit miliona euro në vit. Një profesor i ekonomisë thekson se kundërshtimi i Serbisë ndaj anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare ekonomike dhe politike është duke dëmtuar ekonominë kosovare si dhe për faktin që serbët lokal në pjesën veriore të Kosovës vazhdojnë të kundërshtojnë shtetësinë dhe

---

<sup>27</sup> Intervista 27.

<sup>28</sup> Intervista 51.

<sup>29</sup> Intervista 46.

<sup>30</sup> Raport Zyrtar nga Doganat e Kosovës, i datës 27 shkurt 2018.

<sup>31</sup> Po aty.

<sup>32</sup> Intervista 14; Intervista 49.

<sup>33</sup> Intervista 83.

<sup>34</sup> Intervista 22.

<sup>35</sup> Intervista 14.



institucionet e Kosovës derisa përdorin burimet e saj.<sup>36</sup> Shumica e të intervistuarve argumentojnë se dialogu nuk ka ndihmuar as në zhvillimin ekonomik të Kosovës.<sup>37</sup> Në të vërtetë, pothuajse 2 nga 3 e të intervistuarve<sup>38</sup> nuk shohin ndonjë ndikim pozitiv të dialogut në ekonomi krahasuar me 1 në 6<sup>39</sup> që pohojnë të kundërtën dhe 1 në 5<sup>40</sup> që nuk shohin ndonjë ndikim pozitiv ose negativ.

Sidoqoftë, të intervistuarit në përgjithësi e kanë nënvlerësuar ndikimin e MSA-së në ekonominë e Kosovës në kuptimin e përparësive që krijon për sektorin e bizneseve Kosovare duke ofruar qasje në një treg të përbashkët prej rreth 500 milion konsumatorëve. Edhe pse nuk është një rezultat i drejtpërdrejt i dialogut, nënshkrimi i MSA-së ishte i lidhur ngushtë me progresin e përgjithshëm në dialog.

### 3.2. Ndikimi i dialogut në integrimin Euro-Atlantik të Kosovës dhe pjesëmarrjes së plotë në sistemin/bashkësinë ndërkombëtare

Ndonëse dialogu i Brukselit ka të bëjë kryesisht me marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë, megjithatë është i lidhur ngushtë edhe me procese të tjera të brendshme dhe rajonale/ndërkombëtare. Pavarësisht faktit që Kosova dhe Serbia kanë arritur një marrëveshje mbi përfaqësimin rajonal të Kosovës, e cili pritej që t'i lejoj Kosovës të marrë pjesë në organizata dhe takime të ndryshme rajonale, me kusht që fjala “Kosovë” të shoqërohet me një yll dhe me një fusnotë, Serbia ka vërtetuar të jetë një kundërshtar i vendosur i anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Kështu që, suksesi i Kosovës në rritjen e pjesëmarrjes së saj në forume rajonale ka qenë i kufizuar.

Sipas fjalëve të një ish- Zyrtares Qeveritare, pavarësisht pritjes që Kosova do të bëhet anëtare në të gjitha organizatat rajonale, “në secilën prej tyre ka pasur kushte specifike, në secilën prej tyre Serbët nuk vepruan siç duhet, dhe provuan të bllokojnë aty ku ata patën mundësi,

---

<sup>36</sup> Intervista 43.

<sup>37</sup> Intervista 38; Intervista 48.

<sup>38</sup> Intervista 55; Intervista 28; Intervista 37; Intervista 11; Intervista 25; Intervista 36; Intervista 27; Intervista 60; Intervista 45; Intervista 56; Intervista 15; Intervista 1; Intervista 43; Intervista 21; Intervista 85; Intervista 17; Intervista 87; Intervista 30; Intervista 9; Intervista 52; Intervista 91; Intervista 41; Intervista 79; Intervista 98; Intervista 8; Intervista 34; Intervista 38; Intervista 26; Intervista 33; Intervista 68; Intervista 16; Intervista 23; Intervista 48; Intervista 72; Intervista 80; Intervista 71; Intervista 31; Intervista 24; Intervista 67; Intervista 44; Intervista 40; Intervista 13; Intervista 6; Intervista 14; Intervista 32; Intervista 7; Intervista 69; Intervista 62; Intervista 57; Intervista 3; Intervista 39; Intervista 20; Intervista 5; Intervista 50; Intervista 82; Intervista 65; Intervista 29; Intervista 88; Intervista 70; Intervista 73; Intervista 42.

<sup>39</sup> Intervista 59; Intervista 2; Intervista 83; Intervista 4; Intervista 97; Intervista 12; Intervista 81; Intervista 90; Intervista 46; Intervista 95; Intervista 19; Intervista 64; Intervista 86; Intervista 10; Intervista 53; Intervista 18.

<sup>40</sup> Intervista 47; Intervista 84; Intervista 22; Intervista 63; Intervista 78; Intervista 49; Intervista 94; Intervista 66; Intervista 61; Intervista 35; Intervista 99; Intervista 100; Intervista 74; Intervista 51; Intervista 75; Intervista 89; Intervista 96; Intervista 92; Intervista 54.

provuan të vononin aty ku mundën, provuan të minojnë marrëveshjen e Brukselit në lidhje me anëtarësimin dhe pjesëmarrjen aty ku iu krijua mundësia.”<sup>41</sup>

Obstruksioni i Serbisë u bë i dukshëm mbi të gjitha në rastin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në UNESCO në vitin 2015. Jo vetëm Serbia që arriti të kufizoj përkrahjen ndërkombëtare në anëtarësimin e Kosovës por gjithashtu zhvilloi një fushatë agresive dhe nënçmuese kundër Kosovës duke e paraqitur atë në një frymë jashtëzakonisht negative. Anëtarësimi në UNESCO kishte për qëllim të lajmëronte një epokë të re në politikën e jashtme të Kosovës dhe një ndryshim nga njohjet individuale në anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Edhe pse ishte afër anëtarësimit, dështimi për t'u bërë pjesë e UNESCO-së mbetet dështimi më i madh i politikës së jashtme të Kosovës. Megjithatë, ndërsa vendi dështoi të arrinte ndonjë organizatë të madhe ndërkombëtare politike dhe kulturore, Kosova bëri një përparim në sport, fillimisht duke i'u bashkuar Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (KON), dhe së fundmi në FIFA dhe UEFA pavarësisht nga refuzimi i Serbisë. Kjo ka një ndikim të madh tek të rinjtë për vetë faktin që klubet sportive të Kosovës mund të marrin pjesë në gara ndërkombëtare si futboll, basketboll, xhudo etj. Në të njëjtën kohë, disa ekipe të famshme ndërkombëtare (p.sh., Milano, Barcelona, etj.) po tregojnë interesim për të rinjtë duke dërguar skautët e tyre për të identifikuar talentët në Kosovë.

Pavarësisht kësaj, shumë të intervistuar për këtë studim theksojnë rëndësinë e dialogut për avancimin e agjendës Evropiane të Kosovës, dhe gjithashtu në drejtim të përfitimit të më shumë njohjeve ndërkombëtare:

Pa dialogun [Kosova] nuk do të kishte aftësinë të krijonte mundësi për njohje të reja si shtet. Për më tepër, nuk do të ishte në gjendje të arrinte progres në anëtarësimin në BE dhe gjithashtu në NATO. Prandaj, Kosova nuk do të kishte mbështetje ndërkombëtare për njohje të reja nëse nuk ka marrëdhënie të mira me fqinjët e saj. Dialogu është i vetmi mjet për të përballuar çështjet që Kosova ka me Serbinë.<sup>42</sup>

---

<sup>41</sup> Intervista 39.

<sup>42</sup> Intervista 1.

Kur flasim për negociatat në Bruksel aty kemi shumë anë pozitive (...) pa dialogun, nuk kemi integrim Evropian të Serbisë dhe Kosovës dhe populli i Kosovës do të dëmtohej më së shumti në këtë rast.<sup>43</sup>

Kosova është një projekt ndërkombëtar dhe theksohet që përmes dialogut duhet të zgjidh problemet e saj. Pa dialogun, Kosova do të kishte pasoja në progres të Agjendës Europiane.<sup>44</sup>

Kosova ka arritur në shtrirjen e sovranitetit, avancimin e Agjendës Evropiane dhe gjithashtu njohjen ndërkombëtare të saj. Për më shumë, Kosova tani ka mundësinë të ecë përmes rrugës së integritit në mekanizmat ndërkombëtarë duke thënë se dialogu ka hapur këtë mundësi për Kosovën. Pa dialogun, Kosova dhe Serbia do të humbisnin shumë.<sup>45</sup>

Kosova me dialogun e Brukselit ka arritur efektin e saj në kuadër të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë; ka dëshmuar besueshmërinë e vendit tonë që ne jemi gati për të zgjidhur dilemat në mënyre paqësore.<sup>46</sup>

Klima pozitive që ka rezultuar nga dialogu ka ndihmuar në përfshirjen më të gjerë rajonale të Kosovës si dhe në krijimin e një forme të konsensusit brenda BE-së, në bazë të perspektivës Evropiane të Kosovës dhe themelimin e marrëdhënieve bilaterale (dypaleshë) në formë të MSA-së. Gjithashtu, dialogu ka pasur efekte pozitive në rritjen e bashkëpunimit rajonal përmes 'Procesit të Berlinit' me pjesëmarrjen e dy shteteve.

Për Kosovën procesi ka sjellur përfitime të konsiderueshme në lidhje me pjesëmarrjen në një iniciativë të madhe të BE-së, duke qëndruar në mënyrë të barabartë me Bashkimin Evropian dhe me fqinjët e saj në lidhje me projektet dhe pjesëmarrjen në Procesin e Berlinit, duke fituar një projekt mbi transportin dhe miratimin e iniciativave më të mëdha rajonale.<sup>47</sup>

Anasjelltas, sipas disa të intervistuarve, "Kosova ka shërbyer vetëm si një urë e Serbisë për të arritur gjithçka që ata kanë dëshiruar drejtë rrugës së integritit në BE"<sup>48</sup> dhe efekti i vetëm që e ka pasur ka qenë "rehabilitimi i Serbisë si një shtet normal."<sup>49</sup> Në anën tjetër, ata argumentojnë që, përfitimet e Kosovës ishin shumë të limituara, veçanërisht në drejtim të integritit në BE.

---

<sup>43</sup> Intervista 90.

<sup>44</sup> Intervista 91.

<sup>45</sup> Intervista 7.

<sup>46</sup> Intervista 59.

<sup>47</sup> Grupi për Hulumtim të Politikave të Ballkanit (BPRG) (2018) *Procesi i Berlinit për Ballkanin Perëndimor: Dobi dhe Sfidat për Kosovën*. [http://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2018/01/THE-BERLIN-PROCESS-FOR-THE-WESTERN-BALKANS\\_GAINS-AND-CHALLENGES-FOR-KOSOVO.pdf](http://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2018/01/THE-BERLIN-PROCESS-FOR-THE-WESTERN-BALKANS_GAINS-AND-CHALLENGES-FOR-KOSOVO.pdf)

<sup>48</sup> Intervista 27.

<sup>49</sup> Intervista 52.

Në fakt, të arriturat e Kosovës ishin të limituara në nënshkrimin e marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim me BE-në në vitin 2015; Kosova ende mbetet i vetmi shtet në Ballkanin Perëndimor që nuk ka liberalizim të vizave me BE-në dhe nuk ka apikuar për statusin e vendit kandidat. Për më shumë, pavarësisht optimizmit fillestar, brenda qarqeve të politikës së BE-së dhe liderëve të Kosovës, BE-ja akoma nuk flet me një zë kur është fjala për Kosovën, me 5 vendet mosnjohëse që qëndrojnë të palëkundur në pozicionin e tyre për të mos e njohur pavarësinë e Kosovës. Më tutje, dialogu i Brukselit ka qenë pak i përdorshëm në krijimin e mundësive për Kosovën për të thyer disa pengesa në drejtim të rritjes së bashkëpunimit me vendet mosnjohëse si dhe në pozicionimin e saj ndërkombëtar. Për shembull, pavarësisht nga rritja e lirisë së lëvizjes së njerëzve dhe të mirave në mes Kosovës dhe Serbisë, marrëdhëniet e Kosovës me Bosnjë-Hercegovinën nuk janë përmirësuar, në masë të madhe për shkak të një pozicioni të ngurtë të udhëheqjes së Republikës Srpska. Po ashtu, pavarësisht nga indikacionet që dialogu i Brukselit do të shkaktonte një valë të re njohjesh, duke përfshirë edhe nga 5 vendet mosnjohëse të BE-së, procesi ka ngecur dhe njohjet e reja kanë qenë të pakëta dhe të largëta prej vitit 2011.

Kështuqë, 1 në 3 të intervistuar<sup>50</sup> argumenton që procesi i dialogut ka pasur një ndikim pozitiv në integrimin Euro-Atlantik të Kosovës; kurse pothuajse gjysma prej tyre<sup>51</sup> nuk shohin ndonjë impakt pozitiv. Për më tepër, në këtë kontekst, një në katër prej të intervistuarve ka patur mendime neutrale në këtë drejtim.<sup>52</sup> Ngjashëm me këto mendime ishin shprehur edhe në lidhje me rolin e progresit në njohje dhe në pjesëmarrje të plotë të Kosovës në sistemin/kbashkësinomunitetin ndërkombëtar: një në katër prej të intervistuarve<sup>53</sup> pohon se dialogu ka pasur ndikim pozitiv, derisa 1 në 2<sup>54</sup> pohon se nuk

---

<sup>50</sup> Intervista 55; Intervista 83; Intervista 15; Intervista 12; Intervista 81; Intervista 21; Intervista 49; Intervista 90; Intervista 91; Intervista 46; Intervista 98; Intervista 8; Intervista 95; Intervista 19; Intervista 16; Intervista 48; Intervista 64; Intervista 24; Intervista 44; Intervista 86; Intervista 7; Intervista 62; Intervista 10; Intervista 20; Intervista 53; Intervista 5; Intervista 50; Intervista 65; Intervista 29; Intervista 18; Intervista 1.

<sup>51</sup> Intervista 22; Intervista 37; Intervista 11; Intervista 25; Intervista 27; Intervista 60; Intervista 45; Intervista 56; Intervista 4; Intervista 42; Intervista 85; Intervista 17; Intervista 87; Intervista 30; Intervista 52; Intervista 9; Intervista 41; Intervista 79; Intervista 34; Intervista 38; Intervista 33; Intervista 100; Intervista 26; Intervista 43; Intervista 68; Intervista 23; Intervista 72; Intervista 80; Intervista 71; Intervista 67; Intervista 40; Intervista 13; Intervista 6; Intervista 32; Intervista 69; Intervista 57; Intervista 3; Intervista 39; Intervista 76; Intervista 82; Intervista 88; Intervista 70.

<sup>52</sup> Intervista 47; Intervista 28; Intervista 84; Intervista 36; Intervista 2; Intervista 63; Intervista 78; Intervista 94; Intervista 66; Intervista 61; Intervista 35; Intervista 99; Intervista 74; Intervista 51; Intervista 31; Intervista 14; Intervista 75; Intervista 89; Intervista 96; Intervista 92; Intervista 54; Intervista 73.

<sup>53</sup> Intervista 59; Intervista 37; Intervista 83; Intervista 97; Intervista 15; Intervista 1; Intervista 81; Intervista 49; Intervista 90; Intervista 46; Intervista 79; Intervista 98; Intervista 95; Intervista 19; Intervista 48; Intervista 64; Intervista 71; Intervista 44; Intervista 86; Intervista 7; Intervista 62; Intervista 10; Intervista 76; Intervista 53; Intervista 5; Intervista 50; Intervista 18.

<sup>54</sup> Intervista 55; Intervista 28; Intervista 22; Intervista 11; Intervista 25; Intervista 84; Intervista 36; Intervista 27; Intervista 60; Intervista 45; Intervista 56; Intervista 4; Intervista 12; Intervista 43; Intervista 21; Intervista 85; Intervista 17; Intervista 87; Intervista 30; Intervista 52; Intervista 9; Intervista 91; Intervista 41; Intervista 8; Intervista 34; Intervista 38; Intervista 33; Intervista 26; Intervista 100; Intervista 68; Intervista 16; Intervista 23; Intervista 72; Intervista 80; Intervista 31; Intervista 67; Intervista 40; Intervista 13; Intervista 6; Intervista 14; Intervista 32; Intervista 69; Intervista 57; Intervista 3; Intervista 20; Intervista 82; Intervista 65; Intervista 29; Intervista 88; Intervista 70; Intervista 73; Intervista 42.

shohin ndonjë ndikim pozitiv. Në anën tjetër, 1 prej 5 të intervistuarve<sup>55</sup> mendojnë se dialogu nuk kishte ndikim as pozitiv e as negativ.

### 3.4. Dialogu me pak fjalë

Pothuajse shtatë vite të negociimit kanë prodhuar arritje të dukshme dhe të konsiderueshme për Kosovën, por një normalizim i plotë/gjithëpërfshirës i marrëdhënieve mbetet një çështje e pazgjidhur. Fushata agresive e Serbisë kundër njohjeve të Kosovës në nivel ndërkombëtar dhe anëtarësimit të saj në organizatat ndërkombëtare, si dhe instrumentalizimi i plotë i *Listës Serbe* nga qeveria e Serbisë demonstrojnë ndikimin e kufizuar të dialogut në një normalizim të plotë të marrëdhënieve në mes të dy fqinjëve.

Me pak fjalë, pavarësisht arritjes më të madhe – normalizimin e dialogut,<sup>56</sup> formati aktual i dialogut të Brukselit ka arritur limitet e tij<sup>57</sup> dhe vështirë se do të arrijë ndonjë rezultat thelbësorë pa një ndryshim të formatit të dialogut dhe nxitjen për një marrëveshje ligjërish të detyrueshme në mes të dy vendeve. Status kuo-ja aktuale është bërë e paqëndrueshme dhe vetëm rrit rrezikun e ripërtrirjes së dhunës dhe paqëndrueshmërisë politike në rajon. Ulja e angazhimit amerikan në Ballkan, i kombinuar me rritjen e ndërhyrjes së Rusisë dhe një BE që është e hutuar, jo-unike, dhe hezituese, bëjnë që status kuo-ja në Kosovë dhe në rajon të jetë e paqëndrueshme.<sup>58</sup>

'Dykuptimësia kreative' e BE-së dhe qasja e saj 'neutrale ndaj statusit', e cila ishte e rëndësishme në thyerjen e pengesës në vitin 2011, jo vetëm që ka arritur kulminacionin e saj të 'përdorimit', por gjithashtu ka bërë të pamundur vazhdimin e dialogut dhe arritjen e marrëveshjeve të reja pa u marrë me çështjen kryesore, që është, statusi i Kosovës. Praktika ka dëshmuar se edhe pse marrëveshja e vitit 2013 supozon që sistemi ligjor i Kosovës është suprem në territorin e Kosovës, këmbëngulja e Serbisë për karakterin e 'statusit neutral' të marrëveshjeve shpesh është bërë barrierë e pakalueshme për zbatimin e dispozitave të saj dhe të marrëveshjeve të tjera pasuese. Po ashtu, qasja e 'neutrale ndaj

---

<sup>55</sup> Intervista 47; Intervista 2; Intervista 63; Intervista 78; Intervista 94; Intervista 66; Intervista 61; Intervista 35; Intervista 99; Intervista 74; Intervista 51; Intervista 24; Intervista 75; Intervista 39; Intervista 89; Intervista 96; Intervista 92; Intervista 54.

<sup>56</sup> Intervista 98.

<sup>57</sup> Intervista 24.

<sup>58</sup> Daniel P. Serwer (2017) 'Shturja e Marrëveshjeve të paqes në Ballkan', *Këshilli për marrëdhënie të jashtme*, 8 Nëntor. [https://www.cfr.org/report/unraveling-balkans-peace-agreements?utm\\_medium=social\\_share&utm\\_source=li](https://www.cfr.org/report/unraveling-balkans-peace-agreements?utm_medium=social_share&utm_source=li)

statusit' e BE-së është bërë një pengesë e madhe për Kosovën në rrugën e saj drejt integritimit në BE dhe Strategjia e fundit e zgjerimit të BE-së (shkurt 2018) është një provë shtesë për këtë.

#### 4. Përgatitja për 'finalen e madhe': Çfarë lloj dialogu dhe formati?

Pavarësisht nga mendimet mbizotëruese në Bruksel që dialogu aktual ka qenë i suksesshëm në vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe në zgjerimin e shtrirjes institucionale të Kosovës në zonat e dominuara nga Serbët, një kombinim i faktorëve që ndërlidhet me lodhjen e akterëve ndërkombëtarë të angazhuar në rajon, rritjen e frikës për zgjerimin e ndërhyrjes Ruse dhe kuptimi i përgjithshëm se status kuo-ja nuk është e qëndrueshme, duket se kanë shtyrë në drejtim të një marrëveshje të re dhe ndoshta finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në veçanti, Gjermania dhe SHBA-të duken të etura për përdorimin e kushtëzimit të BE-së (kapitulli 35) për të shtyrë Serbinë drejt një marrëveshje të detyrueshme ligjore me Kosovën që eventualisht do të stabilizonte rajonin.

Strategjia e zgjerimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor përshkruan qartë rrugën për normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë. Në fakt, duhet të jetë një marrëveshje gjithëpërfshirëse e detyrueshme ligjore në mes të Serbisë dhe Kosovës në mënyrë që ato të avancojnë në rrugët e tyre Evropiane.<sup>59</sup> Kjo gjithashtu është rikonfirmuar nga Përfaqësuesja e lartë/Zëvendës-Presidentja Federica Mogherini e cila ka deklaruar se "Një marrëveshje normalizimi gjithëpërfshirëse, detyrimisht ligjore në mes të Serbisë dhe Kosovës do të jetë thelbësore për përparimin e tyre respektiv në rrugën Evropiane.<sup>60</sup> Në këtë kontekst, pritet që nga mes i vitit 2019, Serbia të përmbushë kriteret e saj që përfshijnë edhe mbylljen e kapitullit 35<sup>61</sup>, duke arritur një marrëveshje me Kosovën. Gjithashtu, Kosova do të përfitojë në mënyrë të konsiderueshme nga një marrëveshje definitive për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë.<sup>62</sup> Deri në datën kur Serbia mbyll të

---

<sup>59</sup> Komisioni Evropian (2018) Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve (fq. 17). E disponueshme: [https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf)

<sup>60</sup> Veprimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian (2018). Strategjia e Ballkanit Perëndimor: BE përcakton një rrugë të qartë për anëtarësim. E disponueshme: [https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/39450/western-balkans-strategy-eu-sets-out-clear-path-accession\\_en](https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/39450/western-balkans-strategy-eu-sets-out-clear-path-accession_en)

<sup>61</sup> Shiko fusnotën 59 (fq. 8).

<sup>62</sup> Shiko fusnotën 59 (fq.8).

gjithë kapitujt, sipas të gjitha gjasave në vitin 2023 një pjesë e konsiderueshme e këtyre marrëveshjeve në mes të dy shteteve duhet të implementohet sipas disa diplomatëve Gjerman. Kjo është një agjendë shumë ambicioze e cila do të kërkoj bashkëpunim të gjerë, dhe koordinim në tri nivele. Në shtëpi, institucionet dhe elita e Kosovës duhet të shfrytëzojnë këtë mundësi për t'u përgatitur sa më shpejtë që është e mundur. Në Serbi, "dialogu i brendshëm" i vazhdueshëm ka zgjeruar diskutimet dhe debatin për marrëveshjen e mundshme me Kosovën, por akoma nuk i përshkruan opsionet. Përkundër vullnetit të deklaruar të bashkësisë ndërkombëtare dhe institucioneve të BE-së, duket se ata mund të shfaqin mungesë të koordinimit për procesin që të ketë sukses. BE-ja me përkrahjen e shteteve të saj kryesore anëtare dhe SHBA-ja duhet të paraqesin një kornizë dhe të përkrahin Kosovën dhe Serbinë duke përfunduar kështu këtë synim gjithëpërfshirës.

Shumica e të intervistuarve, veçanërisht nga ana e shqiptarëve të Kosovës, shprehin kritikën e tyre dhe nxjerrin në pah kufizimet dhe mangësitë e dialogut aktual, dhe ata tentojnë të fajësojnë Serbinë për pengimin e dialogut ose moszbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara. Një element tjetër kritik që është theksuar gjatë punësive<sup>63</sup> është e lidhur me performancën e dobët të institucioneve shtetërore të Kosovës në kontekstin e brendshëm dhe rajonal (p.sh., qeverisja e dobët, korrupsioni dhe krimi i organizuar, demarkacioni i kufirit me Malin e Zi, etj.). Disa të intervistuar vënë theksin te fakti se dialogu nuk ka prodhuar më shumë rezultate për shkak të ngurrimit të Serbisë për të respektuar të gjitha marrëveshjet dhe për të shpërbërë strukturat e saj shtetërore në Kosovë. Prandaj, sipas një profesori universitar në Prishtinë, "alternativa do të ishte organizimi i dialogut bazuar në parimin se nuk arrihen marrëveshje të reja para se të zbatohen marrëveshjet ekzistuese".<sup>64</sup>

Sipas njërit nga ish-Kryeministrat e Kosovës, ekziston një dallim thelbësor në mënyrën sesi Kosova dhe Serbia e kuptojnë dialogun. Së pari, derisa Kosova synon të integroj Serbët në sistemin dhe shoqërinë Kosovare, Serbia kërkon të shpërbëj/distancoj ata nga shqiptarët dhe nga institucionet e Kosovës. Së dyti, derisa Kosova punon për të akomoduar Serbët lokal brenda sistemit Kosovar, Serbia përpiqet të përdorë dialogun për të akomoduar

---

<sup>63</sup> Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga BPRG dhe RIDEA në Prishtinë, 19/12/2017; Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga RIDEA dhe BPRG në Prishtinë, 16/01/2018.

<sup>64</sup> Intervista 28.

institucionet dhe ligjet e saj në Kosovë në mënyrë që Serbët e Kosovës të jenë pjesë e sistemit dhe shoqërisë Serbe, megjithëse fizikisht janë pjesë e Kosovës.<sup>65</sup>

Një numër i të intervistuarve aluduan në favor të një roli më aktiv të Serbëve lokal në këtë proces. Një deputet opozitar theksoi se qëllimi kryesor i dialogut në mes Prishtinës dhe Beogradit ishte të krijojë një situatë në të cilën Serbët e Kosovës janë të përfaqësuar nga Beogradi; "Megjithëse është menduar si një mënyrë e shpejtë për normalizimin e marrëdhënieve Serbo-Shqiptare, efekti i një qasjeje të tillë u vërtetua të jetë i dëmshëm në shumë mënyra. Serbët e Kosovës kanë humbur mundësinë për përfaqësim autentik lokal; partitë lokale Serbe kanë pushuar së funksionuari si dhe komunikuari me shumicën Shqiptare dhe Serbët lokal."<sup>66</sup> Sipas një deputeti Rom, pjesëmarrja e Serbëve të Kosovës në dialog si pjesë e ekipit të Kosovës do të rriste përgjegjësinë dhe zërin e tyre.<sup>67</sup> Një tjetër alternativë do të ishte "për Kosovën të fillojë një dialog me Serbët lokal, një dialog të hapur, demokratik dhe shoqëror, nga poshtë- lartë, për zhvillim."<sup>68</sup>

Pa dyshim, qëndrimi dominues në Kosovë është se formati i tanishëm i dialogut ka arritur limitet e tij dhe ka nevojë për të kaluar në fazën përfundimtare të dialogut që do të sillte normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve. Siç e theksoi një gazetar senior i një gazete të Prishtinës, "Unë nuk besoj se ndalimi i dialogut tani do të ishte i dobishëm, por në të njëjtën kohë, vazhdimi i dialogut të bazuar në të njëjtat premisa nuk sjell ndonjë përfitim."<sup>69</sup>

#### **4.1. Cilat duhet të jenë objektivat e dialogut të ri?**

Bazuar nga të intervistuarit, kur trajtohet faza përfundimtare e dialogut, faktori i parë i rëndësishëm lidhet me kornizën kohore dhe një udhërrëfyes të qartë. Siç e ka theksuar një këshilltar i Presidentit të Kosovës, "as Kosova e as Serbia nuk kanë potencial për të mbetur peng i një dialogu pa qëllime për 10 vitet e ardhshme."<sup>70</sup> Prandaj ekziston nevoja për një kornizë të dialogut që përfshin një afat dhe një rrugë të qartë për Kosovën, ku Serbia nuk

---

<sup>65</sup> Intervista 59.

<sup>66</sup> Intervista 41.

<sup>67</sup> Intervista 36.

<sup>68</sup> Intervista 38.

<sup>69</sup> Intervista 37.

<sup>70</sup> Intervista 1.



blokon legalitetin ndërkombëtar të Kosovës, e cila nënkupton gjithashtu një rrugë të garantuar drejtë OKB-së dhe njohje reciproke”.<sup>71</sup>

Një faktor tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me dykuptimësinë politike dhe ligjore; faza e ardhshme duhet të shmang këtë paqartësi që është provuar të jetë problematike kur është fjala për zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese.<sup>72</sup> Ashtu, siç thekson një studiues i bazuar në Prishtinë, “Unë mendoj që nëse vazhdon të prodhojë marrëveshje të cilat nuk do të zbatohen, nuk ka asnjë arsye për të zhvilluar dialogun jo për hir të asaj që duhet të kemi një dialog, sepse është shëndrruar në një shfaqje për të cilën po përfiton klasa politike në Kosovë dhe në Serbi dhe jo domosdoshmërisht qytetarët.”<sup>73</sup> Kështuqë, nevoja për dialog që përfshin një marrëveshje formale përfundimtare dhe ligjërish të detyrueshme në formën e një traktati mbi marrëdhënie të mira dhe bashkëpunimit fqinjësor, që do të ratifikohej në dy parlamentet.<sup>74</sup>

Janë propozuar objektiva të tjera komplementare nga të intervistuarit të cilat përfshijnë normalizimin e marrëdhënieve që garanton anëtarësimin e plotë ndërkombëtar të Kosovës pa ndryshuar rendin kushtetues të Kosovës dhe garancione të qarta dhe të afatizuara në kuptimin e anëtarësimit të Kosovës dhe Serbisë në BE.<sup>75</sup> Të tjerët theksojnë nevojën për të përfshirë obligime të përbashkëta dhe garancione për mbrojtje dhe respektim të të drejtave të minoriteteve në Kosovë dhe Serbi, si dhe një angazhim i qartë për të punuar së bashku për një të ardhme të ndritur pa penguar njëra-tjetrën, sepse njohja (implicite apo eksplicite) nuk është e mjaftueshme nëse dy shtetet nuk bashkëpunojnë me njëra tjetrën në të ardhmen.<sup>76</sup>

Disa të intervistuar të tjerë theksojnë rëndësinë e përqendrimit në çështjet parësore për qytetarët dhe më pas të kalojë në çështje më të mëdha. Dialogu duhet të merret me zgjidhje konkrete për të mirën e popullatës, sepse nëse zgjidhen problemet e përditshme të qytetarëve, arritja e zgjidhjes përfundimtare do të jetë shumë më e lehtë.”<sup>77</sup> Një grup tjetër

---

<sup>71</sup> Intervista 22; Intervista 84; Intervista 83; Intervista 56; Intervista 15; Intervista 32; Intervista 82.

<sup>72</sup> Intervista 37; Intervista 44.

<sup>73</sup> Intervista 68.

<sup>74</sup> Intervista 59; Intervista 25; Intervista 36; Intervista 2; Intervista 27; Intervista 60; Intervista 63; Intervista 12; Intervista 85; Intervista 17; Intervista 41; Intervista 46; Intervista 19; Intervista 23; Intervista 48; Intervista 80; Intervista 75; Intervista 20; Intervista 50; Intervista 73; Intervista 42.

<sup>75</sup> Intervista 37; Intervista 61; Intervista 38; Intervista 74; Intervista 51; Intervista 24; Intervista 54.

<sup>76</sup> Intervista 55; Intervista 4; Intervista 1; Intervista 81; Intervista 49; Intervista 91; Intervista 79; Intervista 68; Intervista 99; Intervista 40; Intervista 89; Intervista 70.

<sup>77</sup> Intervista 93; Intervista 30; Intervista 94; Intervista 90; Intervista 66; Intervista 13; Intervista 86; Intervista 62; Intervista 57; Intervista 3; Intervista 88.

i të intervistuarve nxjerr në pah domosdoshmërinë e vlerësimit të gjendjes aktuale sa i përket zbatimit e marrëveshjeve të deritanishme.<sup>78</sup> Shkurtimisht, siç u diskutua mësipër këto ishin pikëpamjet e të intervistuarve mbi objektivat e një dialogu të ri.

#### 4.2. Si të organizojmë dialogun e ri? Kush duhet të përfshihet?

Mendimet e të intervistuarve sa i përket format të ri dhe pjesëmarrësve janë shumë të ndryshme. Disa të intervistuar argumentojnë se Kosova duhet të insistoj në rritjen e rolit të SHBA-së dhe Gjermanisë.<sup>79</sup> Në fakt, të dy Presidenti i Kosovës dhe Kryeministri<sup>80</sup> kanë kërkuar vazhdimisht për një përfshirje direkte të SHBA-së në këtë proces. Sipas një ish-zyrtari të lartë të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja në mes të Prishtinës dhe Beogradit, “faza përfundimtare duhet të ketë një kornizë kohore të qartë, duhet të jetë e fokusuar, më e shkurtër dhe me ndërmjetësimin e BE-së dhe SHBA-së. Mendoj që ndërmjetësimi (më shumë sesa lehtësimi) nga pala e tretë do të garantonte përfundimin e kësaj faze dhe do të shtynte Serbinë për zbatim”.<sup>81</sup> Përfshirja e SHBA-së konsiderohet esenciale sidomos duke pasur parasysh faktin se BE-ja nuk flet me një zë kur bëhet fjalë për Kosovën si rezultat i 5 vendeve që nuk e njohin pavarësinë e saj.

Një numër i të intervistuarve kanë favorizuar një përfshirje më të gjerë<sup>82</sup> në dialog, duke përfshirë shoqërinë civile dhe botën akademike, dhe ndoshta edhe krijimin e një grupi të unitetit,<sup>83</sup> ngjashëm me atë në 2005-7. Minoritetet jo-Serbe do të dëshironin një pjesëmarrje më të gjerë të përfaqësuesve të tyre në bisedimet e ardhshme.<sup>84</sup> Të intervistuar të tjerë ngritën çështjen e mungesës së transparencës dhe informimit më të gjerë publik.<sup>85</sup> Veçanërisht, ata sugjerojnë, që Kuvendi i Kosovës duhet të luaj rol esencial në këtë proces.<sup>86</sup> E një rëndësie të veçantë është edhe ndërtimi i një konsensusi sa më të

---

<sup>78</sup> Intervista 11; Intervista 43; Intervista 95; Intervista 18; Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga RIDEA dhe BPRG në Prishtinë, 16/01/2018.

<sup>79</sup> Intervista 73; Intervista 62; Intervista 75; Intervista 59; Intervista 51.

<sup>80</sup> Beta (2017) 'Haradinaj kërkon që Shtetet e Bashkuara të përfshihen në negociatat për Kosovën,' B92, 9 qershor. [https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=06&dd=09&nav\\_id=101508](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=06&dd=09&nav_id=101508)

<sup>81</sup> Intervista 46.

<sup>82</sup> Intervista 47; Intervista 100; Intervista 7; Intervista 10; Intervista 92; Intervista 5.

<sup>83</sup> Intervista 35; Intervista 55; Intervista 59.

<sup>84</sup> Intervista 35.

<sup>85</sup> Intervista 12; Intervista 45; Intervista 70; Intervista 13; Intervista 29.

<sup>86</sup> Intervista 45; Intervista 97; Intervista 78; Intervista 21; Intervista 87; Intervista 9; Intervista 26; Intervista 16; Intervista 67; Intervista 69; Intervista 33; Intervista 52; Intervista 37; Intervista 11; Intervista 67; Intervista 34; Intervista 48.

gjerë shoqëror dhe nacional, dhe ndoshta edhe të organizohet një referendum<sup>87</sup> për marrëveshjen eventuale finale. Sipas disa deputetëve të Kuvendit të Kosovës:

Për të hyrë në këtë fazë të dialogut me Serbinë, Kosova së pari duhet të ketë konsensusin e saj të brendshëm politik, t'i përgjigjet vetes se çfarë do të thotë normalizimi për ne, të përcaktojë vijat e kuqe dhe të kërkojë një afat kohor strikt maksimalisht prej tetëmbëdhjetë muajsh.<sup>88</sup>

Mendoj se kjo nuk është një çështje për një parti politike apo një sektor të popullsisë sonë, është një interes kombëtar, është çështje e interesit tonë kombëtar dhe mendoj që gjithë spektri politik duhet të përfshihet, ashtu si në të kaluarën kur kishim Ekipin e Unitetit, kur diskutoheshin çështje të caktuara me Serbinë dhe kështu me radhë.<sup>89</sup>

Konsensusi politik konsiderohet i domosdoshëm për shkak të përçarjes politike që ka rezultuar në Kosovë gjatë viteve të fundit lidhur me çështjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, dialogun me Serbinë, si dhe fragjilitetin e qeverisë (në aspektin e mbështetjes së saj të kufizuar në parlament).<sup>90</sup>

Megjithatë, sipas ish-zëvendësministrit të Punëve të Jashtme të Kosovës,

Unë nuk pajtohem se ka ndonjë kohë kudo që të jetë e mundur për të pasur një konsensus rreth dialogut. Unë nuk mendoj se ka pasur një konsensus në dialogun në Kolumbi, nuk mendoj se ka pasur një konsensus në Irlandë dhe konsensusi është gjëja më e kërkuar në historinë e gjërave të stërpjetura. Nëse mund të ratifikosh, nëse mund të votosh, kjo është ajo. Ju nuk mund të keni që të gjithë të bien dakord për diçka, sepse keni nacionalist, liberal, të djathtë, të majtë, njerëz në qeveri dhe njerëz kundër qeverisë.<sup>91</sup>

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar që ai ka për qëllim të ndërtoj një grup të unitetit si përgatitje për fazën përfundimtare të dialogut.<sup>92</sup> Opozita dhe disa vëzhgues të pavarur kanë kundërshtuar këtë dhe kanë vërë në pikëpyetje besueshmërinë e z. Thaçi për të udhëhequr procesin në emër të Kosovës. "Formati është më pak i rëndësishëm, përderisa objektivat janë të qarta dhe ekziston një konsensus i gjerë politik në këto

---

<sup>87</sup> Intervista 4.

<sup>88</sup> Intervista 23.

<sup>89</sup> Intervista 51.

<sup>90</sup> Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga BPRG dhe RIDEA në Prishtinë, 19/12/2017

<sup>91</sup> Intervista 18.

<sup>92</sup> Thaçi: Ekipi i Unitetit të themelohet për negociatën, *Ballkani European Perëndimor*, 30 Gusht 2017, <https://europeanwesternbalkans.com/2017/08/30/thaci-unity-team-established-negotiations/>

objektiva, dhe atëherë ne partitë politike duhet të nominojmë përfaqësuesit; kush thotë që duhet të jetë Presidenti i Kosovës, nëse duam dikë tjetër që është më kredibil se ai.”<sup>93</sup>

Të tjerët argumentojnë se meqë Kosova është shtet dhe ka institucionet e saj, ata duhet të udhëheqin konsultimet me opozitën, dhe shoqëria civile duhet të ketë një rol konsultativ.<sup>94</sup> Sipas disa pjesëmarrësve në punëtori,<sup>95</sup> dialogu në nivelin presidencial do të dëmtonte Kosovën sepse derisa z. Vučić është në kulmin e fuqisë politike, z. Thaçi është ndoshta në pikën më të dobët sa i përket fuqisë politike dhe ndikimit të tij.

Sidoqoftë, shqetësimet ka edhe për mungesën e qartësisë në kuadrin e negociatave dhe qëllimeve dhe kornizën afatshkurtër (2018-2019) për nënshkrimin e një marrëveshjeje të re që është përmendur në mesin e institucioneve dhe diplomatëve të ndryshëm të BE-së; veçanërisht kjo konsiderohet problematike për Kosovën, e cila duket se nuk ka stabilitetin e duhur institucional, konsensusin e të gjerë politik dhe garancitë e qarta për çështjen e njohjes reciproke.<sup>96</sup> Po ashtu, mbetet e paqartë se si BE-ja dëshiron ta kalojë në një fazë të re të dialogut pa zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe mungesën e një mekanizmi të duhur të monitorimit.<sup>97</sup> Prandaj, duke pasur parasysh një periudhë diplomatike intensive në vijim, në njërin nga punëtoritë u sugjerua që Kosova mund të rriste fuqinë e saj negociatore nëpërmjet: a) ndërtimit të kohezionit të brendshëm politik, b) përmirësimit të imazhit jashtë vendit dhe c) të menduarit e alternativave.<sup>98</sup>

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i diskutuar në një nga punëtoritë është i lidhur me faktin që agjenda e përgjithshme politike e Kosovës është dominuar plotësisht nga dialogu i Brukselit. Kështuqë, u sugjerua që Kosova duhet të gjejë mënyra për të vazhduar agjendën e saj të ndërtimit të shtetit, sëbrendshmi (reformat institucionale në arsim, shëndetësi, zhvillim ekonomik) dhe sëjashtmi (njohje ndërkombëtare, diplomaci ekonomike etj.), paralelisht me procesin e dialogut.<sup>99</sup>

---

<sup>93</sup> Intervista 23.

<sup>94</sup> Intervista 24.

<sup>95</sup> Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga BPRG dhe RIDEA në Prishtinë, 19/12/2017

<sup>96</sup> Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga BPRG dhe RIDEA në Prishtinë, 19/12/2017

<sup>97</sup> Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga BPRG dhe RIDEA në Prishtinë, 16/01/2018

<sup>98</sup> Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga BPRG dhe RIDEA në Prishtinë, 19/12/2017

<sup>99</sup> Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga BPRG dhe RIDEA në Prishtinë, 16/01/2018

Në pika të shkurtra, opinionet ndryshojnë nga ideja mbizotëruese se negociatat duhet të hyjnë në fazën e tyre përfundimtare, me idenë e ndërtimit të një platforme kombëtare<sup>100</sup> dhe konsensusit sa më të gjerë politik me parlamentin në qendër, deri te idetë më radikale që negociatat duhet të vazhdojnë vetëm pasi "Serbia kërkon ndjesë për krimet e kryera në Kosovë dhe më pas vazhdon me njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe pastaj vazhdon me marrëveshjen për dëmshpërblimin e dëmeve të luftës, fondin e pensioneve, kthimin e artefakteve, etj."<sup>101</sup> Një sugjerim i rëndësishëm ndërlidhet edhe me zgjerimin e hapësirës së dialogut duke përfshirë dimensionin shoqëror të dialogut midis shoqërisë Kosovare dhe Serbe.<sup>102</sup> Emëruesi i përbashkët është se në një mënyrë të gjitha institucionet duhet të përfshihen drejtpërdrejt në fazën përfundimtare të dialogut: kjo mund të përfshij krijimin e një ekipi ku përfshihen partitë politike, shoqëria civile dhe bota akademike që mund të jetë nën kujdesin e Presidentit; një komision relevant brenda Kuvendit të Kosovës; dhe një zyrë specifike për zbatimin e marrëveshjeve brenda Qeverisë së Kosovës (Zyrës së Kryeministrit).

## 5. Diskutimi i skenarëve të mundshëm

Vlen të përmendet se lista e skenarëve të mundshëm mund të jetë mjaft e gjerë. Për shembull, në vitin 2014 qeveria e Kosovës ka paraqitur në Bruksel një dokument që përmban pikat kryesore që duhet të diskutohen në *fazën përfundimtare* të negociatave. Ky dokument përmban 5 pika kryesore: 1) Vendosjen e kufirit ndërkombëtar në mes të dy shteteve/demarkacioni ndërshtetëror i kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë; 2) Njohje reciproke në mes të dy shteteve. Respektimi i raporteve të fqinjësisë së mirë në mes të dy shteteve dhe mos ndërhyrja në sovranitetin e njëri tjetrit. Përfundimi i ndërhyrjes së Serbisë në Kosovë në zonat tjera që nuk janë të adresuara në Marrëveshjet e Brukselit, të 19 Prillit 2013, dhe të dialogut teknik; 3) Vendosja e bashkëpunimit ndërshtetëror në zonat që kanë interes të përbashkët, në përputhje me standardet Evropiane dhe Evro-Atlantike;

---

<sup>100</sup> Intervista 14.

<sup>101</sup> Intervista 25.

<sup>102</sup> Intervista 24.

4) Dëmet e luftës; 5) Sukcesioni mbi parimin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, ku Kosova ishte një nga tetë njësitë federale.<sup>103</sup>

Është e rëndësishme të theksohet se jo vetëm që Kosova përgatitet për 'finalen e madhe' me Serbinë. Po ashtu, autoritetet serbe kanë nisur dialogun e brendshëm mbi Kosovën. Promovuar nga presidenti serb Alexander Vuçiç, në nëntor 2017 u formua një grup pune "për të dëgjuar pikëpamjet e qytetarëve ... dhe për të përmbledhur mendimet". Një debat i gjerë publik rreth Kosovës po vazhdon përmes përfshirjes së OJQ-ve, botës akademike, politikanëve dhe opinion-bërësve. Diskutimet deri tani kanë prodhuar disa ide që mund të përmbliidhen në një numër të opsioneve rreth të cilave formohet politika.<sup>104</sup> Opsioni i parë është interpretuar si mos bëj asgjë, presim, prolongojme, derisa Rusia të bëhet më e fuqishme. Deri atëherë, në 5-10 vjet, Serbia mund të luftoj për të rikthyer pavarësinë dhe kufijtë e Kosovës. Opsioni i dytë përfshin ruajtjen e status kuo-së "flasim vetëm për marrëveshjen e parë dhe presim derisa BE dhe SHBA të paraqesin një opion tjetër dhe Rusia mund të sjellë opsione të tjera në tryezë ...".<sup>105</sup> Më shumë opsione të ardhshme përfshijnë "negociatat për një Marrëveshje Gjithëpërfshirëse, e cila do të përfshinte çdo gjë, por jo ulëse në OKB për Kosovën dhe pa njohje" ... dhe opsioni i katërt përfshin atë të preferuar, "Një marrëveshje gjithëpërfshirëse me njohje në termat Serbe... " Kosova e pavarur me kufij të ndryshuar. Kjo ka tërhequr mbështetje të gjerë në Serbi.<sup>106</sup> Autoritetet serbe po kërkojnë nga BE dhe shtetet anëtare që t'u tregojnë atyre se cili "është minimumi për një marrëveshje gjithëpërfshirëse..., duke argumentuar se një tjetër Marrëveshje Brukseli, që mund të quhet *Brukseli Dy*, do të ishte e mjaftueshme për të arritur normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Kosovën".<sup>107</sup> Sipas pikëpamjes së tyre, një marrëveshje e re e ndërtuar mbi Marrëveshjen e Parë mbi Normalizimin e Marrëdhënieve mund të ndihmojë Serbinë të mbyllë kapitullin 35 dhe në praktikë nuk do të ndryshojë qëndrimin e Serbisë mbi statusin e Kosovës.<sup>108</sup> Ky lloj marrëveshjeje mund të përfshijë njohjen e autoritetit dhe juridiksionit të Kosovës nga Serbia, ndryshimin e ligjeve në Serbi me ndikim në Kosovë, heqjen e të gjitha strukturave paralele nga Kosova, marrëveshjen

<sup>103</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, Kabineti i Zëvendëskryeminitrës Edita Tahiri (2014) *Dialogu i Brukselit - Temat për fazat e ardhshme*. Prishtinë. Mars 29. [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/BRUSSELS\\_DIALOGUE\\_TOPICS\\_FOR\\_NEXT\\_PHASE\\_310314-signed.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/BRUSSELS_DIALOGUE_TOPICS_FOR_NEXT_PHASE_310314-signed.pdf)

<sup>104</sup> Intervista të Grupit Ballkanik me anëtarët e grupit punues, Beograd, dhjetor 2017.

<sup>105</sup> Po aty.

<sup>106</sup> Intervistat e Grupit Ballkanik me Zyrat qeveritar, opinion-bërësit dhe analist, Beograd, tetor-dhjetor 2017. Shih për më shumë: <http://www.novimagazin.rs/vesti/intervju-ivan-vejvoda-razmena-teritorija-sa-kosovom-nije-iskljucena>

<sup>107</sup> Intervistë e Grupit Ballkanik, Zyrtar i lartë qeveritar, Zyra për "Kosovë dhe Metohi", Beograd, nëntor 2017.

<sup>108</sup> Po aty.

mbi hapësirën ajrore, etj. Para se të vihet në dispozicion ndonjë ofertë serioze, udhëheqja e Beogradit mund të propozojë "Unionin e dy shteteve", të paktën si zgjidhje të përkohshme, sugjeron një burim qeveritar në Beograd.<sup>109</sup>

Siç mund të shihet, Kosova ka paraqitur në Bruksel disa nga temat për fazën përfundimtare të negociatave dhe në Serbi lista e skenarëve potencial/hipotetikë dhe modaliteteve nga 'dialogu i brendshëm' janë mjaft të gjera.

Në vijim, dhe në bazë të intervistave dhe burimeve të tjera të shpjeguara në *seksionin e metodologjisë*, paraqiten në mënyrë të përmbledhur tre skenarët dhe modalitetet e ndryshme brenda tyre, si dhe diskutohen arsyeshmëria dhe gjasat e materializimit të tyre si dhe, më e rëndësishmja, potenciali i tyre për të gjeneruar një normalizim të plotë të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe një paqe të qëndrueshme në rajon.

### 5.1. Skenari I: Vazhdimi i status quo-së

Ky skenar përfshin dy modalitete të ndryshme:

#### ***I (a). Jo-dialog (ndërprerje e dialogut) – qasja 'prit dhe shiko'.***

Sipas këtij skenari, i cili deri diku është një skenar jo mirë i menduar, nuk do të ketë dialog, ku të dyja palët do të qëndronin në pozicione diametralisht të kundërta në çështjet kyçe që kanë të bëjnë me statusin e Kosovës dhe ndërhyrjen e Serbisë në Kosovë. Me siguri, një skenar i tillë do të çimentonte ndarjen aktuale etnike si dhe mbivendosjen e institucioneve Kosovare dhe Serbe në Kosovë, dhe për më keq mund të rrezikonte nivelin e stabilitetit (relativ) dhe komunikimin politik ndëretnik në Kosovë.

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga BE mbetet një çështje përçarëse dhe e politizuar në Kosovë. Megjithkëtë, shumica e të intervistuarve, përveç dallimeve në interpretimin e qëllimeve, përfitimeve dhe modaliteteve të ardhshme të dialogut, e mbështesin dialogun si mjet për gjetjen e një zgjidhjeje për çështjet e hapura politike në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pjesa dërmuese e të intervistuarve argumentojnë

---

<sup>109</sup> Po aty.

që dialogu nuk ka alternativë.<sup>110</sup> Refuzimi i dialogut do të kishte pasoja të tmerrshme, duke përfshirë izolimin e Kosovës si dhe stagnimin e përgjithshëm.<sup>111</sup> Shumë nga të intervistuarit, nënvizojnë rreziqet që kanë të bëjnë me tërheqjen eventuale nga dialogu:

Cili është plani B? Plan B është me Stambollin, me Moskën, me Lindjen e Mesme? Nuk ka Kosova plan B në kuptimin e vet gjeo-politik [...] Pa dialog, Kosova do të ishte hapave të sigurt drejt 'shtetit të dështuar'. S'ka alternativë në raport me dialogun; ne duhet të mësohemi të jetojmë me idenë që të krijojmë një zone komforte të aranzhimeve dhe kompromiseve. Duke pas parasysh dilemat e shtetndërtimit në Kosovë, s'ka mënyrë se si ato mund të zgjidhen pa një formë kompromisi.<sup>112</sup>

Kësisoj, disa të tjerë pohojnë që, tërheqja nga dialogu do të shërbente vetëm për të zbehur pozicionin e Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare, ku Kosova nuk do të shihej si faktor stabiliteti, por vetëm si eksportues i problemeve.<sup>113</sup> Disa të tjerë paralajmërojnë, se poqëse dialogu ndërpritet, atëherë nuk do të ketë përparime në integrimin në BE, ku statusi i komunitetit Serb nuk do të përmirësohej, dhe rrjedhimisht tensionet vetëm sa do të rriteshin.<sup>114</sup>

Për më tepër, të intervistuarit rrjedhimisht argumentojnë që pala kosovare do të dukej si jo bashkëpunuese dhe e painteresuar për dialog<sup>115</sup>, çka do të çonte gjithashtu në ndërprerjen e implementimit të marrëveshjeve.<sup>116</sup>

Për më keq, refuzimi i dialogut mund të sjellë rrezikun e "rrëshqitjes në të gjitha llojet e opsioneve ekstreme dhe të dhunshme"<sup>117</sup> dhe "do të ishte thjesht e dëmshme për tërë procesin, nëse nuk bisedoni ju do të duhej të shkonit në luftë dhe nëse nuk doni të shkoni në luftë duhet të bisedoni".<sup>118</sup> Frika është se tërheqja nga dialogu do të kthente *status quo ante* (gjendjen e mëparshme): "gjërat mund të kthehen aty ku ishin në pikën fillestare dhe të gjitha arritjet e Kosovës mund të zhbëheshin, dhe mund të ktheheshim në një situatë ku nuk do të kishim qasje në atë pjesë [veriu i Kosovës]".<sup>119</sup>

---

<sup>110</sup> Intervista 57; Intervista 63; Intervista 55; Intervista 53; Intervista 31; Intervista 20; Intervista 7; Intervista 36; Intervista 86; Intervista 76; Intervista 9; Intervista 39.

<sup>111</sup> Intervista 40; Intervista 1.

<sup>112</sup> Intervista 47.

<sup>113</sup> Intervista 47; Intervista 84; Intervista 31.

<sup>114</sup> Intervista 93; Intervista 90; Intervista 71.

<sup>115</sup> Intervista 2; Intervista 8; Intervista 99.

<sup>116</sup> Intervista 83; Intervista 85; Intervista 21; Intervista 14; Intervista 57; Intervista 29; Intervista 73.

<sup>117</sup> Intervista 96.

<sup>118</sup> Intervista 20.

<sup>119</sup> Intervista 97.



Në vend të ndërprerjes së dialogut, shumë nga të intervistuarit theksojnë nevojën e ridefinimit të tij. Sipas tyre, më mirë sesa të ndërpres dialogun, “Kosova duhet ta përshtas atë me interesat e saja strategjike”<sup>120</sup> duke “forcuar pozitën e saj në dialog.”<sup>121</sup> Një tjetër deputet sugjeron që “Kosova duhet ta ndryshojë tërësisht qasjen: në vend të dialogut për normalizim ne duhet të bisedojmë për marrëdhënie të mira fqinjësore.”<sup>122</sup> Një deputet opozitar insiston për një qasje tjetër në dialog ku Kosova do të përgatistë një platformë nacionale me objektiva të qartë përpara fillimit të negociatave, meqë një gjë e tillë veç ekziston në Serbi.<sup>123</sup>

Një opsion tjetër alternativ sugjeron ndërprerjen e dialogut me Serbinë, dhe zëvendësimin e tij me dialogun me Serbët lokal. Përfaqësues të ndryshëm të serbëve lokalë, komuniteteve jo-shqiptare, dhe disa figura opozitare, mbështesin dialogun e brendshëm me serbët e Kosovës si shumë të rëndësishëm, por jo si zëvendësim i dialogut me Beogradin.<sup>124</sup> Sipas një përfaqësuesi Serb, “dialogu i brendshëm nuk mund të jetë zëvendësues; duhet të jetë një proces normal dhe paralel, pa marrë parasysh dialogun ndër-qeveritar. Është dashur që të ndodh në të kaluarën, tani dhe në të ardhmën, dhe do të duhej të zhvillohej ndarazi, meqenëse dialogu lokal duhet t’i shërbejë dialogut Beograd-Prishtinë në arritjen e marrëveshjeve më të mira, implementim më të mirë, si dhe atmosferë dhe raporte më të mira ndërmjet Serbëve dhe Shqiptarëve në Kosovë.”<sup>125</sup>

Megjithkëtë, në përgjithësi të intervistuarit pohojnë se duke marrë për bazë ndikimin e Serbisë në mesin e serbëve lokalë, atëherë një dialog i brendshëm me serbët lokalë nuk shihet si alternativë e vlefshme karshi dialogut me Serbinë.<sup>126</sup> “Pa normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve, dialogu i brendshëm nuk do të ishte i suksesshëm.”<sup>127</sup> Sipas një përfaqësuesi serb të Kosovës nga shoqëria civile, dialogu i brendshëm është i domosdoshëm, por fatkeqësisht, deri tani ka ndodhur rrallë herë në formë të konferencave dhe tryezave të rrumbullakëta.<sup>128</sup> Sipas, një zyrtari serb në Qeverinë

---

<sup>120</sup> Intervista 24.

<sup>121</sup> Intervista 26.

<sup>122</sup> Intervista 52.

<sup>123</sup> Intervista 16.

<sup>124</sup> Intervista 21; Intervista 3; Intervista 29; Intervista 30; Intervista 72; Intervista 50; Intervista 57; Intervista 25; Intervista 69; Intervista 33; Intervista 42; Intervista 34.

<sup>125</sup> Intervista 53.

<sup>126</sup> Intervista 10; Intervista 8; Intervista 19; Intervista 56; Intervista 60; Intervista 47.

<sup>127</sup> Intervista 24.

<sup>128</sup> Intervista 32.

e Kosovës, për serbët e Kosovës do të ishte e dobishme përfshirja e tyre në dialog, shpeshherë marrëveshjet e arritura pa përfshirjen e tyre, krijojnë probleme në terren.<sup>129</sup>

Sidoqoftë, nuk janë të gjithë kundër ndërprerjes së dialogut. Për disa, duke pasur parasysh mungesën e rezultateve të mëdha, ndoshta ndërprerja e dialogut për momentin nuk do të shkaktoje problem të madh.<sup>130</sup> Të tjerët mendojnë që ndërprerja e dialogut do të kishte më shumë përfitime sesa pasoja,<sup>131</sup> edhe pse pa qenë specifik. Disa kundërshtarë të formatit aktual të dialogut theksojnë faktin që pasojat më të mëdha do të ishin për Serbinë, e cila falë këtij dialogu është duke avancuar me shpejtësi në rrugën e integritit në BE, pa përmbushur ndonjë marrëveshje dhe në të njëjtën kohë duke definuar temat e dialogut të cilat minojnë funksionalitetin e shtetit të Kosovës.<sup>132</sup>

Me pak fjalë, pavarësisht dallimeve lidhur me qëndrimin ndaj formatit aktual të dialogut apo arritjeve/mangësive të tij, vetëm një pjesë e vogël e të intervistuarve mbështesin skenarin 'jo-dialog' (ndërprerje e dialogut).

***I (b). Vazhdimi i dialogut në formatin aktual. BE do ta mbajë (ruajë) nivelin e tanishëm të angazhimit dhe do ta përdorë kushtëzimin për të ushtruar presion mbi Kosovën dhe Serbinë në zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe ndoshta arritjen e marrëveshjeve të reja në fushën e arsimit dhe shëndetësisë por pa i obliguar palët që të nënshkruajnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe juridikisht të detyrueshme.***

Dy faktorë kyç që do të mund të prolongonin status kuo-në kanë të bëjnë me: a) pamundësinë që çështja Kosovë-Serbi të fitojë vëmendje ndërkombëtare për shkak të rëndësisë së çështjeve tjera që kanë të bëjnë me krizën e refugjatëve, problemet e brendshme të BE-së (rritja dhe fuqizimi i partive të djathta), si dhe zvogëlimin e angazhimit të SHBA-së në Ballkan dhe rritjen e ndikimit të Ruisisë; dhe b) mungesën e progresit në implementimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe paqëndrueshmërinë politike në Kosovë dhe Serbi që në vazhdimësi prodhojnë kriza politike dhe zgjedhje të reja.

---

<sup>129</sup> Intervista 83.

<sup>130</sup> Intervista 95; Intervista 23; Intervista 74.

<sup>131</sup> Intervista 56; Intervista 69; Intervista 33.

<sup>132</sup> Intervista 25; Intervista 43; Intervista 52; Intervista 41; Intervista 38; Intervista 82.

Përderisa Kosova është shumë e interesuar në implementimin e modaliteteve të arritura në fushën e energjisë, lirisë së lëvizjes, targave të veturave, e kështu me radhë, qeveritë e njëpasnjëshme në Kosovë kanë zvarritur implementimin e marrëveshjes për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë. Gjërat janë komplikuar si rezultat i protestave opozitare dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës sipas të cilit "Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe do të themelohet, siç është paraparë me Marrëveshjen e Parë [...] Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore", nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës..."<sup>133</sup>

Gjykuar nga klima e tanishme politike në Kosovë, e cila karakterizohet nga ngatërresa dhe konflikte politike midis qeverisë dhe opozitës, si dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese, atëherë procesi i themelimit të Asociacionit/Bashkësisë pritet të marrë kohë. Sigurisht, do të ketë shumë çështje ligjore dhe sfida praktike që do të ngrihen përgjatë rrugës, duke e bërë kështu tërë procesin një përpjekje komplekse. Mbetet për t'u parë nëse kërcënimi i kohëve të fundit nga serbët e Kosovës dhe Serbia për të krijuar njëanshëm Asociacionin/Komunitetin, do t'i nxit institucionet e Kosovës të ndërmarrin hapa konkret drejt krijimit të tij/saj.

Shumë nga të intervistuarit duket se refuzojnë vazhdimin e status kuo-së. Disa pohojnë se nga vazhdimi i status kuo-së në radhë të parë do të përfitonte Serbia, sepse ajo i mundëson minimin në mënyrë aktive të pavarësisë së Kosovës si brenda vendit (nëpërmjet strukturave të saj që janë drejtpërdrejtë të kontrolluara nga partia në pushtet - SNS) dhe ndërkombëtarisht duke bllokuar anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare. Është e rëndësishme që në vend të akomodimit të serbëve lokalë, përmes një dialogu të tillë 'ligjërisht të paqartë', Serbia do të kërkojë më tej akomodimin e strukturave të saj në Kosovë<sup>134</sup>, në veçanti përmes Asociacionit/Bashkësisë.

Vazhdimi i status kuo-së është përkrahur nga disa liderë serbë të Kosovës. Sipas një deputeti serb në Kuvendin e Kosovës dhe udhëheqës partie, tani për tani vazhdimi i status

---

<sup>133</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës (2015). *Rasti Nr. KO130/15*. [http://ëëë.gjk-ks.org/repository/docs/gjk\\_ko\\_130\\_15\\_ang.pdf](http://ëëë.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ko_130_15_ang.pdf)

<sup>134</sup> Intervista 59.

kuo-së do të ishte zgjidhja më e mirë, meqenëse nuk kemi liderë vizionarë si në Prishtinë ashtu edhe në Beograd.<sup>135</sup>

Megjithkëtë, përderisa një skenar i tillë do të sillte dobi për Serbinë - shumë zëra radikalë në Beograd kanë kërkuar ruajtjen e status kuo-së duke shpresuar që konstelacioni politik ndërkombëtar po zhvendoset në favor të Serbisë - i cili do të ruante kontrollin e saj politik dhe financiar mbi serbët lokalë në Kosovë, dhe në të njëjtën kohë do të avanconte në rrugën e saj integruese në BE, dhe me siguri do ta mbante Kosovën në rënie e sipër si në aspektin e ndërtimit të shtetit ashtu edhe në integrimin në BE. Është bërë e qartë se rruga e Kosovës drejt integritit në BE është e bllokuar për aq kohë sa pesë shtetet e BE-së që nuk kanë njohur Kosovën, vazhdojnë të mbajnë qëndrimin e tyre të ngurtë. Për shkak të faktit se rruga e Kosovës për në BE është e lidhur me dialogun me Serbinë, është në interesin e saj që të këmbëngulë në një marrëveshje përfundimtare me Serbinë, e cila do të sillte normalizimin e plotë të marrëdhënieve, do të kompletonte procesin e shtet-ndërtimit dhe do t'i mundësonte përparimin në proceset e integritit Evropian dhe Evro-Atlantik.

Për më tepër, zgjatja e status kuo-së vetëm sa do të rrisë frustrimin në mesin e banorëve lokalë dhe mundësinë që agjendat dhe lëvizjet radikale (politike dhe fetare) të fitonin terren dhe vëmendje publike. Më e rëndësishmja, një zgjatje e status kuo-së aktuale rrezikon të mbyllë Kosovën në kategorinë e "zonave gri të sovranitetit" dhe "konflikteve të ngrira", ngjashëm me shtetet e kontestuara të mbështetura nga Rusia në Kaukaz (Abkazia, Osetia Jugore dhe Transnistria).

Në vazhdim, do diskutojmë shohim dy skenarë të tjerë dhe nën-modalitetet e tyre për një zgjidhje të rebusit Kosovë-Serbi.

## **5.2. Skenari II: normalizimi i plotë i marrëdhënieve përmes një marrëveshje bilaterale/traktati**

Skenari i dytë përfshinë nënshkrimin e një marrëveshje gjithpërfshirëse dhe juridikisht obliguese në mes të Kosovës dhe Serbisë që do të hapte rrugën për normalizimin e vërtetë të marrëdhënieve. Një skenar i tillë, përfshin të paktën dy modalitete të ndryshme:

---

<sup>135</sup> Intervista 57.

***II(a) Normalizimin e plotë përmes njohjes reciproke që konfirmon shtetësinë e Kosovës brenda dhe jashtë, në këmbim të mbrojtjes dhe shtimit të të drejtave politike, kulturore dhe fetare për Serbët e Kosovës (në përputhje me Kushtetutën e Kosovës) si dhe përshpejtimin e integritit të Serbisë në BE.***

Ky është një tjetër skenar për zgjidhjen e çështjes, arritjen e normalizimit të plotë dhe stabilitetin e rajonit. Shumica absolute e të intervistuarve duket se kanë një pikëpamje pozitive për një zgjidhje të tillë.<sup>136</sup> Sipas një zyrtari të lartë të Kosovës për dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja në mes Prishtinës dhe Beogradit, "Kosova e ka bërë të qartë se faza përfundimtare e dialogut duhet të përfundojë në njohjen reciproke midis Kosovës dhe Serbisë, si mënyra e vetme për të vendosur një paqe të qëndrueshme midis dy shteteve, madje edhe të dy kombeve, atij Shqiptar dhe Serb."<sup>137</sup> Gjithashtu, sipas një këshilltari të Presidentit të Kosovës, "opsioni ideal për t'i dhënë fund dialogut do të ishte që Serbia të njohë Kosovën, duke mundësuar anëtarësimin në OKB, me kusht që ne të krijojmë Asociacionin/Bashkësinë dhe eventualisht të rishikojmë një numër të dispozitave dhe të drejtave, duke përfshi mbrojtjen e monumenteve kulturore dhe fetare, në këtë mënyrë ne i ruajmë kufijtë e Kosovës dhe karakterin e saj multi-etnik."<sup>138</sup>

Ngjashëm, shefi i grupit parlamentar të një partie opozitare thotë se "për Kosovën, objektivat duhet të jetë një republikë e pavarur e Kosovës e njohur universalisht, anëtare e OKB-së dhe pa dëmtuar mëtej funksionalitetin e brendshëm të shtetit.<sup>139</sup> Në të njëjtën mënyrë, një deputet i pavarur argumenton se "Objektivi përfundimtar i Kosovës duhet të jetë njohja nga Serbia dhe gjithashtu angazhimi i Serbisë për të mos kundërshtuar më anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare."<sup>140</sup> Sipas një deputeti tjetër opozitar, "Serbia duhet të kërkojë falje për krimet e kaluara, të jetë gati të njohë pavarësinë e Kosovës dhe të paguajë dëmshpërblimet e luftës për shkatërrimin dhe vuajtjet e shkaktuara në të kaluarën."<sup>141</sup>

---

<sup>136</sup> Intervista 2; Intervista 41; Intervista 17; Intervista 45; Intervista 73.

<sup>137</sup> Intervista 46.

<sup>138</sup> Intervista 1.

<sup>139</sup> Intervista 23.

<sup>140</sup> Intervista 51.

<sup>141</sup> Intervista 38.

Përdërisa ideja e njohjes së plotë të pavarësisë është shumë tërheqëse për shumicën e të intervistuarve, ata janë shumë të kujdesshëm ndaj rreziqeve që lidhen me çmimin që Kosova duhet të paguajë në këmbim të ofertës së mundshme të Serbisë për të njohur Kosovën. Prandaj, një theksi i veçantë i është kushtuar linjave të kuqe të Kosovës në dialogun e ardhshëm: nuk do të diskutohet mbi rendin kushtetues, propozimin e Ahtisarit, pavarësinë dhe integritetin territorial.<sup>142</sup> Për më tepër, një në dhjetë<sup>143</sup> të intervistuar ka shprehur një pikëpamje pozitive për koncesionet e mëtejshme nga ana e Kosovës në dialog, 2 në 3<sup>144</sup> pohuan të kenë një pikëpamje negative (pa koncesione të mëtejshme), dhe 1 në 8<sup>145</sup> të intervistuar ishin neutral. Kjo ilustron faktin se shumica e të intervistuarve janë kundër çdo koncesioni tjetër.

Vijat e kuqe të dialogut u përsëritën edhe nga ish-zyrtari i lartë i Kosovës për dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja midis Prishtinës dhe Beogradit; "Kosova ka siguruar të drejta të mjaftueshme për pakicën serbe, përtej çdo standardi ndërkombëtar. Për shembull, minoritetet serbe paraqesin afërsisht 5% të popullsisë së Kosovës, derisa kanë 25% të komunave të Kosovës."<sup>146</sup> Prandaj, në Bruksel, Kosova dhe Serbia duhet të dialogojnë për marrëdhëniet ndërshtetërore dhe jo për rendin e brendshëm kushtetues të Kosovës, sepse kjo është një çështje kushtetuese për të cilën vendosin qytetarët e Kosovës", pohon kryeredaktori i një gazete ditore në Prishtinë.<sup>147</sup>

Në fakt, ashtu siç e ritheksojnë shumë nga të intervistuarit, Kosova ka bërë shumë për të zbatuar planin e Ahtisarit dhe për të siguruar të drejta dhe mbrojtje të gjerë për komunitetet jo shumicë. Për më tepër, dialogu i vazhdueshëm ka shtuar një dimension të ri për mbrojtjen dhe të drejtat e komunitetit serb, që në mënyrë të konsiderueshme shkon përtej dispozitave origjinale të planit të Ahtisarit dhe në raste të caktuara edhe e tejkalon atë. Në njëfarë mënyre, dialogu i Brukselit ka krijuar konturat e një marrëveshjeje Ahtisaari

---

<sup>142</sup> Intervista 61; Intervista 64; Intervista 66; Intervista 28; Intervista 55; Intervista 37; Intervista 63; Intervista 48; Intervista 45; Intervista 42; Intervista 50; Intervista 60; Intervista 69; Intervista 72; Intervista 74.

<sup>143</sup> Intervista 22; Intervista 4; Intervista 95; Intervista 100; Intervista 31; Intervista 40; Intervista 6; Intervista 7; Intervista 60.

<sup>144</sup> Intervista 28; Intervista 59; Intervista 37; Intervista 11; Intervista 25; Intervista 84; Intervista 36; Intervista 2; Intervista 83; Intervista 27; Intervista 45; Intervista 56; Intervista 63; Intervista 97; Intervista 78; Intervista 1; Intervista 12; Intervista 81; Intervista 43; Intervista 21; Intervista 49; Intervista 85; Intervista 30; Intervista 52; Intervista 94; Intervista 90; Intervista 91; Intervista 9; Intervista 41; Intervista 46; Intervista 79; Intervista 66; Intervista 98; Intervista 8; Intervista 61; Intervista 34; Intervista 35; Intervista 38; Intervista 68; Intervista 16; Intervista 23; Intervista 99; Intervista 48; Intervista 72; Intervista 64; Intervista 51; Intervista 80; Intervista 71; Intervista 24; Intervista 67; Intervista 44; Intervista 13; Intervista 14; Intervista 69; Intervista 62; Intervista 57; Intervista 3; Intervista 39; Intervista 10; Intervista 76; Intervista 92; Intervista 20; Intervista 5; Intervista 50; Intervista 82; Intervista 29; Intervista 88; Intervista 70; Intervista 18; Intervista 54; Intervista 33; Intervista 42.

<sup>145</sup> Intervista 47; Intervista 15; Intervista 17; Intervista 87; Intervista 19; Intervista 26; Intervista 74; Intervista 86; Intervista 32; Intervista 75; Intervista 89; Intervista 53; Intervista 65.

<sup>146</sup> Intervista 46.

<sup>147</sup> Intervista 37.

'Plus', mirëpo pa njohjen e Kosovës nga Serbia. Sipas një ish anëtar të Ekipit Negociator të Kosovës në Vjenë, "Problemi nuk qëndron me Planin e Ahtisarit. Problemi rrjedh nga dialogu politik në Bruksel, i cili nuk do duhej të kishte ndodhur, e që më pas ka shkuar përtej Planit të Ahtisarit."<sup>148</sup>

Frika në Kosovë është se Serbia do të arrijë të realizojë të drejta më të gjëra për serbët lokalë, madje edhe autonomi territoriale dhe politike, duke ruajtur njëkohësisht pozicionin e saj të mosnjohjes. Sipas një deputeti opozitar, "Kosova nuk mund të bëjë kompromis më të madh sesa Asociacioni i Komunave Serbe".<sup>149</sup> Sipas një profesori universitar, "vija e kuqe e Kosovës duhet të jetë shmangia e sovranitetit të dyfishtë në veri, si dhe shmangia e çdo dispozite që pengon funksionalitetin e saj institucional dhe menaxhimin e burimeve natyrore, një gjë që ishte garantuar edhe me kushtetutën e vitit 1974."<sup>150</sup>

Sa i përket çështjes së arsimit, kujdesit shëndetësor dhe trashëgimisë kulturore, disa nga të intervistuarit pajtohen që ato duhet të rregullohen ekskluzivisht sipas dispozitave të Planit të Ahtisaarit dhe Kushtetutës së Kosovës.<sup>151</sup> Sipas një këshilltari të Presidentit të Kosovës, "komunitetit serb i është garantuar e drejta për të mbajtur lidhje me Serbinë, në këtë mënyrë Serbia mund të ofrojë ndihmë për komunitetin serb në Kosovë, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështjet arsimore dhe kulturore. Ne tashmë kemi kornizën, prandaj vetëm duhet të punojmë në zbatimin e kornizës së Planit të Ahtisaarit."<sup>152</sup> Megjithkëtë, një zyrtar serb në Qeverinë e Kosovës mendon se për shkak të çështjeve që lidhen me buxhetin, si dhe me praktikën e ndryshme të trajnimit dhe organizimit, veçanërisht në sektorin e shëndetësisë, është shumë e vështirë për Kosovën që t'i integrojë ato brenda sistemit të saj.<sup>153</sup>

Sipas një këshilltari të Presidentit të Kosovës, "Kosova duhet të insistojë në zbatimin e plotë të planit të Ahtisarit dhe ta pasurojë atë me dispozita që nuk do ta kundërshtonin shtetësinë e Kosovës, por që do të siguronin integrimin e mëtejshëm të komunitetit serb."<sup>154</sup> Një deputet tjetër insiston në atë që "mënyra më e mirë për të integruar

---

<sup>148</sup> Intervista 74.

<sup>149</sup> Intervista 62.

<sup>150</sup> Intervista 14.

<sup>151</sup> Intervista 68; Intervista 70.

<sup>152</sup> Intervista 83.

<sup>153</sup> Intervista 86.

<sup>154</sup> Intervista 49.

komunitetin Serb dhe çdo komunitet tjetër që jeton në Kosovë është sigurimi i mirëqenies."<sup>155</sup>

Sipas këtij skenari, përveç njohjes së plotë dhe të qartë të Kosovës nga Serbia, Kosova duhet të insistojë në një pako më të gjerë që përfshin detyrime shtesë për Serbinë në lidhje me dëmshpërblimet e luftës, zgjidhjen e problemit të personave të zhdukur,<sup>156</sup> si dhe kthimin e pronave dhe kthimin e fondit pensional.<sup>157</sup>

Kthimi i fondit pensional është shumë i rëndësishëm; bëhet fjalë për 2.1 miliard Euro të kontributeve të qytetarëve të Kosovës që rrinë në Beograd dhe që janë vjedhur më 1999. Kjo është e para. Një kërkesë e rëndësishme primare është kthimi i trupave të personave të pagjetur porq y nuk është një proces njëanshëm sepse kemi persona të pagjetur edhe nga pakicat.<sup>158</sup>

Megjithkëtë, disa të intervistuar insistojnë në veçimin e çështjes së fundit, meqenëse "çështja e personave të zhdukur është një detyrim ligjor dhe mungesa e zbatimit të tij mund të çojë në ndëshkime sipas së Drejtës Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut. Ky është një obligim ligjor dhe nuk duhet të vendoset si kusht politik."<sup>159</sup>

Edhe pse këto janë çështje thelbësore dhe Kosova duhet të insistojë në to, është shumë e vështirë që në kontekstin dhe rrethanat ekzistuese, Kosova do të jetë në pozitë për të imponuar vendime të tilla, sidomos kur bëhet fjalë për reparacione.<sup>160</sup> Në shumë raste, këto çështje janë pjesë e një problemi më të madh që lidhet me çështjen e trashëgimisë shtetërore, e që zakonisht nuk zbatohet në rastin e shkëputjes. Për më tepër, ato janë të ndërlidhura ngushtë me çështje të tjera të ngritura nga Serbia, e që kanë të bëjnë me pronën jugosllave/serbe në Kosovë, borxhin e jashtëm e kështu me radhë.

Disa të intervistuar argumentojnë se Kosova duhet të insistojë në parimin e reciprocitetit kur bëhet fjalë për të drejtat e serbëve në Kosovë dhe shqiptarëve në Serbi,<sup>161</sup> dhe kjo për shkak të përvojës që ka Kosova me të drejtat e pakicave dhe modelit të avancuar të të drejtave afirmative.<sup>162</sup> Në fakt, siç argumenton një publicist në Prishtinë, "Njohja e të

---

<sup>155</sup> Intervista 51.

<sup>156</sup> Intervista 55.

<sup>157</sup> Intervista 59; Intervista 63; Intervista 23; Intervista 14.

<sup>158</sup> Intervista 23.

<sup>159</sup> Intervista 41.

<sup>160</sup> Intervista 5; Intervista 6; Intervista 47; Intervista 20; Intervista 8.

<sup>161</sup> Intervista 18; Intervista 43; Intervista 14; Intervista 13; Intervista 12; Intervista 56; Intervista 64; Intervista 92.

<sup>162</sup> Intervista 13.



drejtave të pakicave në Kosovë, i jep asaj një argument dhe të drejtë që të kërkojë të njëjtën gjë për shqiptarët në rajon."<sup>163</sup>

Si përfundim, pavarësisht përparësive të një skenari të tillë - normalizim i plotë, njohje universale dhe anëtarësim në OKB – është e pagjasë që lidershipi i Serbisë të jetë i gatshëm që ta njohë zyrtarisht Kosovën në këmbim të një anëtarësimi të përshpejtuar në BE. Liderë të ndryshëm Serbë me funksione dhe përkatësi të ndryshme politike kanë përsëritur se Serbia kurrë nuk do ta njohë Kosovën. Për më tepër, anëtarësimi i Serbisë në BE nuk varet vetëm nga marrëdhëniet me Kosovën. Serbia ka përdorur lidhjet e saj të ngushta me Rusinë për qëllime të shantazhit dhe pazarllëkut politik në negociatat me Brukselin. Çka është më e rëndësishme, lidershipi i Serbisë e ka bërë të qartë se zgjidhja përfundimtare duhet të përfshijë një kompromis që do të duhej të kënaqte të dyja palët. Natyrisht, për Serbinë, modeli i avancuar i Kosovës për mbrojtjen e pakicave që rrjedh nga plani i Ahtisaarit dhe i sanksionuar në kushtetutën kosovare, nuk përbën kompromis.

E fundit, por jo për nga rëndësia, është shumë e vështirë që një BE e ndarë, me pesë shtete anëtare që kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës, do të jetë në pozitë që të detyrojë Serbinë të njohë pavarësinë e Kosovës *de jure* dhe mbase as *de facto*. 'Neutraliteti ndaj statusit' i BE-së është një disavantazh i madh për Kosovën, në çdo rast dhe në çdo formë negociuese apo marrëveshje në të ardhmën.

Në vazhdim diskutojmë një formë tjetër të normalizimit të marrëdhënieve, përmes një traktati/marrëveshje dypalëshe. Konkretisht, njohja joformale që eventualisht mund t'i mundësojë Kosovës anëtarësimin në OKB.

***II(b) Kosova dhe Serbia nënshkruajnë një marrëveshje ligjore të obligueshme, me të cilën Serbia njeh sistemin politik dhe ligjor të Kosovës (duke përfshirë mundësinë për të fituar një ulëse në OKB), por pa njohje formale, në këmbim të të drejtave të zgjeruara politike, kulturore dhe fetare dhe mbrojtje për serbët e Kosovës (në përputhje me Kushtetutën e Kosovës), si dhe integrim të përshpejtuar në BE për Serbinë.***

---

<sup>163</sup> Intervista 6.

Ka kohë që, liderë të ndryshëm lokalë dhe diplomatë ndërkombëtarë kanë paralajmëruar idenë që Kosova dhe Serbia të nënshkruajnë një marrëveshje ligjore të obligueshme, e cila *de facto* njeh pavarësinë e Kosovës dhe e lejon që më vonë t'i bashkohet BE-së, në këmbim të të drejtave të zgjeruara për komunitetin Serb në Kosovë, si dhe integrim të shpejtë të Serbisë në BE. Një marrëveshjeje të tillë shpeshherë iu është referuar si 'normalizimi i plotë pa njohje', 'njohja e juridiksionit' ose ' modeli gjerman'. Në të vërtetë, ky modeli i fundit i ishte ofruar të dyja palëve që në vitin 2007 nga ish-përfaqësuesi i BE-së në bisedimet për statusin, Wolfgang Ischinger,<sup>164</sup> por që ishte refuzuar.

Edhe pse në krahasim me njohjen e plotë, një skenar i tillë mbetet si alternativa e dytë më e mirë, ai megjithatë përfshin anëtarësimin eventual të Kosovës në OKB. Anëtarësimi i Kosovës në OKB ka fituar një vlerë më të madhe në sajë të dështimit të saj për t'u anëtarësuar në UNESCO dhe organizata tjera ndërkombëtare. Politikanë të ndryshëm në Kosovë janë të vetëdijshëm se një njohje e tërthortë nga Serbia, që përfshin një ulëse në OKB është gjithçka që Kosova mund të shpresojë në rrethanat ekzistuese.<sup>165</sup>

Disa nga të intervistuarit theksuan rëndësinë që anëtarësimi i Kosovës në OKB të jetë pjesë e marrëveshjes përfundimtare.<sup>166</sup> Sipas një deputeti opozitar, ulësja në OKB duhet të jetë vija e kuqe; "ne nuk mund të humbasim këtë mundësi dhe kemi të drejtë të jemi anëtar i OKB-së, jo si vëzhgues, por si një anëtar i plotë."<sup>167</sup> Në të njëjtën mënyrë, një këshilltar i Presidentit të Kosovës insiston që "Serbia duhet të heqë të gjitha pengesat për t'i mundësuar Kosovës anëtarësimin në OKB, diçka e tillë, gjithashtu do të zhblokonte procesin e njohjes nga 5 shtetet anëtar të BE-së."<sup>168</sup>

Sipas një anëtari të Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës, meqenëse Serbia nuk do ta njoh pavarësinë e Kosovës në 10, 20 apo 30 vitet e ardhshme, Serbia duhet të zotohet ndërkombëtarisht dhe të miratojë një rezolutë në parlament, e cila në mënyrë të qartë deklaron se nuk do të kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare.<sup>169</sup> Një tjetër, thekson faktin se Serbia nuk është problemi i vetëm: "ne

---

<sup>164</sup> Bardh Shkreli (2013) "Modeli i dy Gjermanive Sugjerohet për Kosovën," *Balkan Insight*, 29 Maj. <http://ëëë.balkaninsight.com/en/article/tëo-germanys-model-suggested-for-kosovo/1589/6>

<sup>165</sup> Intervista 40.

<sup>166</sup> Intervista 22; Intervista 15.

<sup>167</sup> Intervista 23.

<sup>168</sup> Intervista 1.

<sup>169</sup> Intervista 56.

duhet të mendojmë edhe për vendet tjera, që gjithashtu e bllokojnë Kosovën. Ne e përqendrojmë energjinë dhe përpjekjet tona në raport me Serbinë, e cila nuk mund të jetë përgjigje për të gjitha problemet tona. Duke e izoluar dhe trajtuar tërë problematikën vetëm në raport me Serbinë, ne nuk mund ta zgjidhim problemin e njohjes në tërësi."<sup>170</sup> Megjithkëtë, ish-Kryetari i Kuvendit të Kosovës është shumë i vendosur për domosdoshmërinë e njohjes reciproke: "Objektivi kryesor duhet të jetë njohja reciproke. Ne nuk duhet të bëjmë kompromis për këtë, edhe nëse procesi do të zgjaste për një shekull."<sup>171</sup>

Edhe pse pjesa më e madhe e lidërshimit në Serbisë e ka përjashtuar pranimin e anëtarësimit të Kosovës në OKB, në një deklaratë të fundit, Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq tha se "nuk ka mundësi që Kosova të ketë një ulëse në Kombet e Bashkuara pa një marrëveshje me Serbinë."<sup>172</sup> Ai vazhdoi duke thënë që "Serbia duhet të marrë diçka" nga ajo marrëveshje - në vend që të "mos të ketë asgjë dhe të poshtërohet." Me fjalë të tjera, Serbia do të ishte e gatshme të lejojë anëtarësimin e Kosovës në OKB, me kusht që Kosova të bëjë koncesione të mëtejshme për serbët lokalë. Edhe pse pozicioni i Serbisë nuk është i formuluar qartë dhe është subjekt i ndryshimit, jo vetëm për shkak të 'debatit të brendshëm për Kosovën' që po vazhdon atje, besohet se kërkesa e saj është një autonomi politike dhe territoriale për pjesën veriore të Kosovës. Në disa raste zyrtarët serbë kanë bërë të qartë se serbët e Kosovës duhet të kenë një nivel të lartë autonomie, bazuar në modelet e aplikuara në vendet tjera nëpër Evropë (p.sh. Katalonia).

Siç u diskutua më sipër, mbizotëron perceptimi dominues në mesin e politikanëve kosovar, komentatorëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile se Kosova nuk është në gjendje të bëjë koncesione të mëtejshme në negociatë, pasi që rrezikon funksionalitetin e saj institucional dhe kushtetues. Refuzimi i Listës Serbe për të votuar transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në një forcë të armatosur përmes ndryshimeve kushtetuese ka ngritur tashmë hijen e Republikës Srpska në Kosovë.

---

<sup>170</sup> Intervista 68.

<sup>171</sup> Intervista 75.

<sup>172</sup> "Kosova mund ta marrë ulësen në OKB vetëm nëpërmjet marrëveshjes me Serbinë," *B92*, 5 Dhjetor 2017. [https://ëëë.b92.net/eng/neës/politics.php?yyyy=2017&mm=12&dd=05&nav\\_id=102957](https://ëëë.b92.net/eng/neës/politics.php?yyyy=2017&mm=12&dd=05&nav_id=102957)

Edhe pse mundësia e një 'shpërblimi' në formën e ulëses në OKB për Kosovën duket shumë tërheqëse, nuk do të garantonte as stabilitetin dhe progresin e Kosovës, dhe as normalizimin e plotë të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, dhe kjo për disa arsye. Së pari, anëtarësimi në OKB mund ta ndihmojë Kosovën në fuqizimin e pozitës ndërkombëtare, por sovraniteti i jashtëm nuk garanton domosdoshmërisht edhe sovranitetin e brendshëm. Mungesa e njohjes formale do t'i japë Serbisë një liri veprimi për të vazhduar obstrukcionet karshi shtetësisë së Kosovës nga brenda (përmes serbëve lokalë dhe Asociacionit/Bashkësisë), duke rrezikuar që ta kthejë atë në një shtet jofunksional, të rrënuar nga ngërçet politike dhe ligjore. Siç thekson një anëtar i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës, "Kosova nuk duhet ta blejë anëtarësimin në OKB me disa lëshime që mund të shkelin sovranitetin dhe integritetin territorial."<sup>173</sup>

Njohja formale konsiderohet thelbësore nga shumë të intervistuar: "Kosova mund të bëhet anëtare e OKB-së, por çështja do të jetë e pazgjidhur, nuk do të kemi marrëdhënie të mira dhe të plota pa njohje"<sup>174</sup>; "Njohja është thelbi i problemit, dhe nëse nuk ka njohje reciproke nuk do të ketë normalizim"<sup>175</sup>; "Palestina është anëtare e OKB-së. Pastaj, edhe Bosnja. Por të dyja janë shtete jofunksionale. Gjëja më e rëndësishme është mirëqenia e qytetarëve, e cila shumë seriozisht mund të rrezikohet nga vendosja e kontruksioneve [politike] të pa qëndrueshme."<sup>176</sup>

Së dyti, anëtarësimi në OKB nuk është aspekti më i rëndësishëm i shtetësisë dhe jo domosdoshmërisht e konfirmon atë. Vlen ta kujtojmë se në të kaluarën entitetet jo shtetërore kanë qenë anëtare të Kombeve të Bashkuara (Ukraina dhe Bjellorusia, si pjesë përbërëse të Bashkimit Sovjetik). Në rast se Kosova do t'i bashkohej OKB-së sipas formulës së Ukrainës dhe Bjellorusisë, atëherë nëse parafrazojmë një ekspert ndërkombëtar, do të kishte subjektivitet të kufizuar ndërkombëtar.<sup>177</sup>

Në anën tjetër, Somalia edhe pse e ka sovranitetin ndërkombëtar dhe është anëtare e OKB-së, që nga viti 1991 është një shtet i dështuar. Thënë shkurt, anëtarësimi në OKB nuk duhet

---

<sup>173</sup> Intervista 92.

<sup>174</sup> Intervista 24.

<sup>175</sup> Intervista 2.

<sup>176</sup> Intervista 52.

<sup>177</sup> Uibopuu, Henn-Jüri. "Personaliteti juridik ndërkombëtar i Republikave të BRSS." *Tremujor i Ligjit ndërkombëtar dhe krahasues*, vol. 24, nr. 4, 1975, f. 811-845.

parë si qëllim në vetvete. Kosovës i është mohuar anëtarësimi në OKB për shkak të refuzimit dhe rezistencës së Serbisë (me përkrahjen e Rusisë); kështu që, mos anëtarësimi në OKB është pasojë e qëndrimit të Serbisë dhe jo anasjelltas.

Për më tepër, siç sugjerojnë disa të intervistuar, marrëveshja e Serbisë për të mos e bllokuar Kosovën në aplikimin e saj për anëtarësimin në OKB nuk do të heqë automatikisht veton ruse (dhe ndoshta kineze) në Këshillin e Sigurimit.<sup>178</sup> Siç shpjegon një aktivist i shoqërisë civile, "edhe sikur Kosova dhe Serbia duan të arrijnë një marrëveshje, ndoshta Rusia përmes pushtetit që ka në Këshillin e Sigurimit nuk do ta lejojë një gjë të tillë. Pra, mendoj se skenari më i keq për ne është që edhe pasi të pajtohemi, Rusia të vazhdojë të krijojë akoma pengesa ligjore."<sup>179</sup>

Sipas një skenari të tillë, Kosova mund të arrijë një avancim të konsiderueshëm në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar me anë të anëtarësimin në OKB, por që nuk do të zgjidhë plotësisht problemin e "shtetësisë", dhe as do të garantojë normalizimin e plotë të marrëdhënieve dhe heqjen e pengesave në rrugën drejt BE-së.

Megjithatë, disa zyrtarë të BE-së mbeten optimist se "një marrëveshje gjithëpërfshirëse në mes Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve, sigurisht do t'ju ndihmonte juve jashtëzakonisht shumë që të bindni vendet tjera që nuk kanë njohur Kosovën, me shpresë se do të ndryshojnë pozicionin e tyre."<sup>180</sup> Sidoqoftë, aktivistët dhe publicistët e shoqërisë civile në Kosovë mbeten skeptikë për fuqinë e BE-së që të garantojë anëtarësimin e Kosovës në OKB, për të cilën vet nuk ka një qëndrim unik edhe një dekadë pas shpalljes së pavarësisë.<sup>181</sup>

Edhe pse në këtë fazë është e vështirë të parashikohet në detaje se cili është skenari dhe ndikimi i tij në terren, një gjë është e sigurt, që çdo dykuptimësi ligjore dhe politike që do të vazhdojë ta mbajë çështjen e statusit në agjendën e Kosovës dhe të Serbisë, do të rrezikojë dhe dëmtojë bashkëpunimin dhe pajtimin në plan afatgjatë.

---

<sup>178</sup> Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga RIDEA dhe BPRG në Prishtinë, 16/01/2018.

<sup>179</sup> Intervista 22.

<sup>180</sup> Intervista 65.

<sup>181</sup> Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga RIDEA dhe BPRG në Prishtinë, 19/12/2017.

### 5.3. Skenari III: Aranzhime të reja territoriale

***Shkëmbimi territorial bazuar në parimin quid pro quo (diçka për diçka): komunitet e dominuara nga Serbët në veri të Kosovës, të cilat mbesin kryesisht nën kontrollin e strukturave të Serbisë, do t'i bashkoheshin Serbisë, ndërsa Lugina e Preshevës do t'i bashkohej Kosovës. Një aranzhim i tillë territorial do të rregullohej përmes një traktati paqeje, me njohje reciproke të garantuar nga BE, SHBA dhe aktorë të tjerë relevantë.***

Ky është skenari më pak i mundshëm, më kompleks dhe potencialisht një skenar i rrezikshëm, por ende mbetet një skenar i mundshëm. Në fakt, ky skenar është i bazuar në deklaratimet e të intervistuarve dhe përfitimet eventuale reciproke që mund t'i kenë Kosova dhe Serbia. Së pari, në parim do të mbyllte mosmarrëveshjen shekullore territoriale mbi Kosovën; 2) Do të mundësonte njohjen e Kosovës nga Serbia si dhe sovranitetin dhe subjektivitetin e plotë ndërkombëtar; 3) Do të zgjeronte sovranitetin e brendshëm, legjitimitetin shtetëror dhe do të mundësonte një integrim më të shpejtë dhe më kuptimplotë për Serbët në sistemin Kosovar, si qytetarë të barabartë; 4) Meqenëse do të ishte një zgjidhje e dakorduar, nuk do të shkelte ndonjë normë ndërkombëtare (p.sh. Akti Final i Helsinkit) dhe nuk do të implikonte ndryshime të mëdha në rajon dhe më gjerë.

Duke pasur parasysh faktin që në këtë rajon, kufijtë janë relativisht qartazi të ndarë në baza etnike (Komuna e Medvegjës, aktualisht ka një shumicë serbe), atëherë nuk do të nënkuptonte ndonjë transferim të madh të popullsisë dhe do të rriste homogjenitetin e të dyja shteteve. Në aspektin territorial, të dyja zonat kanë madhësi të ngjashme: veriu i Kosovës (Mitrovica e Veriut, Zveçani, Leposaviqi, Zubin Potoku) përbëjnë një sipërfaqe afërsisht prej 1007km<sup>2</sup>, ndërsa Lugina e Preshevës (Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë) përbëjnë një sipërfaqe afërsisht prej 1249 km<sup>2</sup>. Në njëfarë mënyre, një zgjidhje e tillë do të nënkuptonte një lloj kthimi në kufijtë etnik/historikë.

Edhe pse pjesë e Serbisë, Lugina e Preshevës është e lidhur ngushtë me Kosovën. Shqiptarët e këtij rajoni theksojnë se ata kanë shumë më pak të drejta vetëqeverisëse krahasuar me serbët në Kosovë; qysh para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, liderët e Preshevës kishin deklaruar përmes një rezolute se do të pranojnë të qëndrojnë në Serbi,

por "në rast ... të ndryshimit eventual të kufijve të Kosovës, Lugina do të angazhohet për bashkim me Kosovën."<sup>182</sup>

E fundit, por jo për nga rëndësia, kjo do t'i siguronte Kosovës mundësinë e vetme të qëndrueshme për të avancuar të drejtat e Shqiptarëve në jug të Serbisë. Përveç retorikës në Prishtinë, institucionet e Kosovës kanë qenë të pafuqishme për të përmirësuar pozicionin e Shqiptarëve në atë rajon. Duke pasur parasysh mungesën e njohjes nga Serbia, Kosova nuk është në pozitë të vendosë masa reciprociteti në mes të drejtave të Serbëve në Kosovë dhe Shqiptarëve në Serbi.<sup>183</sup> Sipas një aktivisti të shoqërisë civile, "ne mund të kemi të drejtë morale dhe detyrim për të thënë diçka, por nuk kemi forcë dhe mundësi, dhe kjo jo vetëm për shkak të Serbisë, por edhe komuniteti ndërkombëtar nuk na pranon si palë përgjegjëse për të diskutuar në emër të shqiptarëve të Luginës."<sup>184</sup>

Megjithkëtë, një marrëveshje e tillë duket e pabesueshme për një varg arsyesh. Së pari, kjo do të nënkuptonte braktisjen e një politike të gjatë të Uashingtonit dhe BE-së për ruajtjen e kufijve. Së dyti, do të shkelte një nga parimet kryesore të Planit të Ahtisaarit dhe kushtetutës së Kosovës: konkretisht, do të minonte integritetin territorial të Kosovës. Së treti, ekziston frika se çdo proces i rregullimit territorial, ka shumë të ngjarë, që të marrë formën e një modaliteti tjetër; respektivisht, ri-përkufizim i gjithë rajonit në bazë të parimit të shumicës etnike lokale/rajonale dhe është e vështirë të implementohet në praktikë pa konflikte të dhunshme.

Një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve<sup>185</sup> nuk e mbështesin ndryshimin e kufijve ekzistues, me arsyetimin se do të shkaktojë një reagim zinxhiror në tërë rajonin,<sup>186</sup> për më tepër do të hapte çështjen e statusit të Kosovës,<sup>187</sup> dhe do të çonte në një konflikt të ri.<sup>188</sup> Disa të tjerë argumentojnë se ky do të "ishte një gabim strategjik" dhe se Kosova do të jetë humbëse në këtë proces.<sup>189</sup>

---

<sup>182</sup>Marko Prelec (2013) 'Ankesat e Preshevës dhe bisedimet Kosovë-Serbi', *Grupi i Krizave*, 1 Shkurt. <http://blog.crisisgroup.org/europe-central-asia/2013/02/01/presevos-grievances-and-the-kosovo-serbia-talks/>

<sup>183</sup> Intervista 55; Intervista 59; Intervista 3; Intervista 45.

<sup>184</sup> Intervista 22.

<sup>185</sup> Intervista 17; Intervista 24; Intervista 9; Intervista 12; Intervista 26; Intervista 27; Intervista 32; Intervista 33; Intervista 35; Intervista 36; Intervista 38; Intervista 42; Intervista 56; Intervista 66.

<sup>186</sup> Intervista 55; Intervista 47; Intervista 28; Intervista 59; Intervista 63; Intervista 53; Intervista 5; Intervista 46; Intervista 62; Intervista 64; Intervista 68; Intervista 69; Intervista 70; Intervista 72.

<sup>187</sup> Intervista 37.

<sup>188</sup> Intervista 13.

<sup>189</sup> Intervista 8; Intervista 7; Intervista 45.

Një anëtar i ekipit negociator të Kosovës në Vjenë nuk beson se një Kosovë e ndarë do të njihet nga Serbia. "Kosova pa integritetin e saj territorial është diçka tjetër dhe jo shteti i Kosovës. Në rast se Serbia pajtohet me ndarjen e Kosovës, këtë nuk e bënë në mënyrë që ta kompensojë atë me njohje, ajo e bën një gjë të tillë pikërisht për të shmangur njohjen dhe për ta ndarë me dikë tjetër."<sup>190</sup>

Disa nga të intervistuarit e kundërshtojnë një skenar të tillë me arsyetimin se ai paraqet një mundësi për projektin e vjetër të "Serbisë së Madhe" dhe kjo shënon një kthim në konfliktet nacionaliste të viteve '90-ta. Sipas zyrtarit të lartë të Kosovës për dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja në mes të Prishtinës dhe Beogradit, "ky është një nga skenarët më të rrezikshëm të Serbisë, i frymëzuar nga ambiciet e ripërtërishme gjeopolitike të Rusisë ndaj Ballkanit, si dhe produkt i një mentaliteti neo-hegjemonik. Kosova është shtet i pavarur dhe është sovran në integritetin territorial dhe kufijtë e saj (...) Serbia po kërkon ndryshimin e kufijve në Kosovë dhe Bosnjë, në përpjekjet e saja për të krijuar Serbinë e Madhe në kurriz të kombeve tjera."<sup>191</sup> Po kështu, një deputet i opozitës argumenton se një skenar i tillë "do të ishte fitore për politikën e Millosheviçit. Nuk duhet të harrojmë se Serbia filloi luftërat në ish-Jugosllavi në mënyrë që të ketë shtetet mono-etnike, Perëndimi kishte ndërhyrë që të mos lejonte fitoren e kësaj politike fashiste, kështu që cila është ideja për t'u kthyer në rrënjët e fashizmit dhe krijimin e këtij shteti mono-etnik."<sup>192</sup> Një mendim të ngjashëm ka edhe një deputet tjetër opozitar: "ndryshimi i kufijve sipas kriterëve etnike së pari nuk do të pranohej ndërkombëtarisht, dhe së dyti, nuk do të lejohej në nivel lokal/rajonat. Të paktën katër shtete në Ballkan do të ishin jashtëzakonisht të shqetësuara nga kjo logjikë: Serbia, Bosnja, Kosova dhe Maqedonia."<sup>193</sup>

Një opsion i tillë do të thoshte që Kosova po i vë në pikëpyetje statusin dhe kufijtë e saj, dhe për më tepër se kaq, rrezikon që të ketë implikime të thella për rajonin dhe të shtyjë procesin e integritetit të Kosovës në BE edhe për 20 vjetët e ardhshme.<sup>194</sup> Sipas një të intervistuarit tjetër, një marrëveshje e tillë nuk do t'i shkonte për shtati as komunitetit serb, meqenëse më shumë serb etnikë jetojnë në jug të lumit Ibër, por as Kosovës nuk i

---

<sup>190</sup> Intervista 54.

<sup>191</sup> Intervista 46.

<sup>192</sup> Intervista 23.

<sup>193</sup> Intervista 41.

<sup>194</sup> Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga RIDEA dhe BPRG në Prishtinë, 19/12/2017.



përshtatet në aspektin ekonomik: ekonomia e Kosovës (bujqësia dhe prodhimi i energjisë elektrike) varet shumë nga liqeni i Ujmanit (Gazivodës).<sup>195</sup>

Megjithatë, nuk janë të gjithë kundër këtij opsioni. Duket sikur këto mendime shfaqen si rezultat i arsyeve të mëposhtme: dështimi i Kosovës që të ketë njohje të plotë, frustrimet rreth procesit të integritetit në BE, kosovarët ndihen sikur Kosova po trajtohet si shtet i dorës së dytë, në mënyrë të pabarabartë, dhe me standarde të dyfishta. Politikanë të ndryshëm në Kosovë<sup>196</sup> dhe në Serbi<sup>197</sup> kanë folur publikisht në mbështetje të rirregullimit të kufijve në baza etnike. Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë ka qenë përkrahës i një ideje të tillë për një kohë të gjatë. Në një deklaratë në verën e vitit 2017 ai bëri thirrje për 'delimitim' të territoreve serbe dhe shqiptare. "Përmes një marrëveshje në mes të serbëve dhe shqiptarëve, si një zgjidhje e përhershme kompromisi, bashkë me një status të veçantë për kishat dhe manastiret tona, si dhe Asociacionin e Komunave Serbe në jug të Kosovës."<sup>198</sup> Më tutje, duke iu përgjigjur kritikëve të tij, Daçiçi thekson se një zgjidhje e tillë do të siguronte një paqe të qëndrueshme: "Nëse Holanda dhe Belgjika mund të shkëmbejnë territore, nëse India dhe Bangladeshi dhe shumë të tjerë mund ta bëjnë këtë, atëherë përse kjo nuk do të lejohej për serbët dhe shqiptarët, përderisa një gjë e tillë garanton paqe në këtë shekull."<sup>199</sup>

Në të njëjtën mënyrë, Presidenti i Serbisë, Vuçiç, në një opinion editorial për të përditshmen Serbe Blic,<sup>200</sup> që në fakt ishte një ftesë e hapur për 'dialog të brendshëm' për Kosovën, kishte deklaruar se "ne duhet të përpiqemi të jemi realist, të mos e humbim apo të mos e japim atë që e kemi, por nuk presim ta marrim atë që e kemi humbur shumë kohë më parë." Në një mënyrë, la të nënkuptohej idenë e shkëmbimit territorial edhe pse asnjëherë nuk e ka deklaruar në mënyrë të qartë.

---

<sup>195</sup> Intervista 83.

<sup>196</sup> Lutfi Haziri: 'Ti këmbëjmë territoret me Serbinë, Lugina e Preshevës 'ti bashkohet Kosovës,' *Bota Sot*, 3 shkurt 2017. <http://www.botasot.info/politika-lajme/649797/lutfi-haziri-perserit-idene-e-shkembimit-te-territoreve-me-serbine/>

<sup>197</sup> Daçiçi kërkon dallim të qartë midis zonave serbe dhe shqiptare në Kosovë, *Novinite*, 31 Korrik 2017.

<http://www.novinite.com/articles/181780/Dacic+Wants+Clear+Distinction+Between+Serbian+and+Albanian+Areas+in+Kosovo>

<sup>198</sup> Beta (2017) "Daçiçi për 'delimitimin' e zonave Serbe dhe Shqiptare të Kosovës," *B92*, 31 Korrik.

[https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=07&dd=31&nav\\_id=101943](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=07&dd=31&nav_id=101943)

<sup>199</sup> Tanjug (2017) 'Daçiçi përmend 'shkëmbimin e territorit'', *B92*, 2 gusht.

[https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=08&dd=02&nav\\_id=101966](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=08&dd=02&nav_id=101966)

<sup>200</sup> Aleksandar Vuçiç (2017) 'Për çfarë na duhet dialogu i brendshëm për Kosovën,' *Blic*, 24 korrik <http://www.blic.rs/vesti/politika/ekskluzivno-autorski-tekst-predsednika-aleksandra-vucica-za-blic-zasto-nam-je/v7xgl6q>

Lidhur me reagimet ndërkombëtare, pozicioni zyrtar i SHBA-së dhe BE-së është kundër këtij opsioni, dhe këtë e kanë thënë në mënyrë të qartë. Por, në këtë kontekst, mund të ketë disa nuanca ose dallime, brenda shteteve të ndryshme të BE-së.

Gjithashtu, një situatë e tillë mund të shmangte edhe veton ruse, pasi që Rusia në vazhdimësi ka përsitur se do të jetë dakord për çfarëdo zgjidhje për të cilën Serbia pajtohet. Gjatë vizitës së fundit të Vuçiçit në Moskë, u dakorduan që "Rusia do të përfaqësojë në mënyrë të denjë pozitën e Beogradit lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës."<sup>201</sup>

Ideja e shkëmbimit territorial nuk është pa fare mbështetje edhe në Kosovë. Sidomos në mesin e aktivistëve të shoqërisë civile dhe qarqeve akademike të cilët nuk përjashtojnë ndonjë marrëveshje e cila sjell një zgjidhje afatgjate.<sup>202</sup> Disa nga mendimet e të intervistuarve mbi këtë çështje:

Unë mendoj që është e pranueshme nëse bëhet nën mbikëqyrje ndërkombëtare, por mendoj që është e vështirë të mendohet që kjo do përkrahej nga BE, OKB apo kushdo tjetër, sidomos nëse e kemi parasysh rastin e Katalonisë. Por, nëse kjo zgjidhje përfshin edhe një marrëveshje për Trepçën, Gazivodën dhe çështjen e pronave, mund të jetë zgjidhje praktike, por që nënkupton ridizajnim të plotë të shtetit të Kosovës.<sup>203</sup>

Kjo ka qenë temë tabu për një kohë të gjatë. Tash dëgjohet gjithnjë e më shumë. Përmendet si zgjidhje e mundshme. Do të ishte zgjidhje e mundur nëse do të përfshinte vetëm Serbinë dhe Kosovën, nëse efektet do të ishin të lokalizuara vetëm në këto dy shtete. Nëse kontesti territorial mes Kosovës dhe Serbisë do të ishte i vetmi në Ballkan, një ndryshim i vogël do të ishte i mundshëm. Problemi është që kjo do të hapte shumë konteste tjera në rajon, dhe për këtë arsye ka pasur shumë hezitim të bashkësia ndërkombëtare, përndryshe çdo gjë është e mundur.<sup>204</sup>

Ky është element i paevitueshëm në një të ardhme jo të largët ... Ky nuk është proces i shpejtë, nuk është proces që duhet të fillohet sot, por në asnjë mënyrë, bindja ime është, nuk duhet heqë dorë prej saj...<sup>205</sup>

---

<sup>201</sup> Vecernje Novosti (2017) "Vuçiç dhe Putin 'pajtohen rreth Kosovës, S-300s, Turkish Stream'", B92, 21 Dhjetor.

[https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=12&dd=21&nav\\_id=103093](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=12&dd=21&nav_id=103093)

<sup>202</sup> Intervista 31; Intervista 22.

<sup>203</sup> Intervista 10.

<sup>204</sup> Intervista 22.

<sup>205</sup> Intervista 75.

Bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën dhe bashkimi i pjesës veriore me Serbinë, për mua, do të ishte në interesin e Kosovës; Kosova do të hiqte nga shpina e vet një barrë të rëndë, krejt veriu me komunat serbe do të jenë barrë historike në shpinën e Kosovës.<sup>206</sup>

Në fakt, (ri)definimi i kufijve bazuar në parimin e vetëvendosjes ka qenë një kërkesë e kahershme e një partie të vogël politike - *Lëvizja për Bashkim*. Sipas një zyrtari të lartë të kësaj partie,

Vija e kuqe për Kosovën duhet të jetë që të mos negociohet vetëm për Kosovën po edhe për Serbinë. Asgjë tjetër nuk është vijë e kuqe për mua, as ndryshimi i kushtetutës dhe kufijve bazuar në marrëveshje të dyanshme ... në rast që ne pajtohemi dhe bashkësia ndërkombëtare pajtohet po ashtu. Unë mendoj që zgjidhja më e mirë është që të pyeten qytetarët që jetojnë në veri të Kosovës dhe ata në Luginë të Preshevës nëse duan të jetojnë në Kosovë apo Serbi. Definimi i kufijve që bazohet në vetëvendosje dallon substancialisht nga shkëmbimi i territoreve. Mendoj që zgjidhja përfundimtare është ridefinimi i kufijve me vullnet të qytetarëve.<sup>207</sup>

Për disa të tjerë, ndryshimi i kufijve duket si një zgjidhje e pranueshme vetëm "nëse asgjë tjetër nuk funksionon."<sup>208</sup> Një mendim i ngjajshëm ishte shprehur edhe nga një zyrtar i Kosovës: "Nëse shkëmbimi territorial do të mundësonte anëtarësimin e Kosovës në OKB, njohjen e saj nga Serbia, si dhe do të mbyllte konfliktin e vjetër shekullor me Serbinë, atëherë kjo do të ishte një zgjidhje e pranueshme dhe funksionale, por në praktikë është e pamundur."<sup>209</sup>

Sipas një deputeti nga koalicioni qeverisës, "në qoftë se dialogu aktual nuk sjell rezultate, atëherë duhet të fillojmë të mendojmë jashtë kornizës aktuale."<sup>210</sup> Sipas mendimit të një aktivisti të shoqërisë civile, "Shkëmbimi i territoreve është gjithmonë i mundur me kusht që të ketë marrëveshje të përbashkët, por dyshoj se do të ketë një marrëveshje për një çështje të tillë."<sup>211</sup> Duke pasur parasysh implikimet më të gjëra rajonale, disa pjesëmarrës në këtë diskutim propozuan një konferencë ndërkombëtare, ku gjithashtu do të diskutoheshin çështjet e pazgjidhura të kufinjve në rajon.<sup>212</sup>

---

<sup>206</sup> Intervista 92.

<sup>207</sup> Intervista 18.

<sup>208</sup> Intervista 20.

<sup>209</sup> Intervista 1.

<sup>210</sup> Intervista 40.

<sup>211</sup> Intervista 60.

<sup>212</sup> Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike dhe mediave, organizuar nga RIDEA dhe BPRG në Prishtinë, 19/12/2017.

Një skenar i tillë ka njëfarë mbështetje edhe në veri të Kosovës: sipas një aktivisti të shoqërisë civile në Mitrovicën e Veriut, edhe pse jo realiste, shkëmbimi i territoreve është një zgjidhje e qëndrueshme, e cila në një mënyre krijon një balancë në Ballkan mes dy kombeve më të mëdha (serbëve dhe shqiptarëve).<sup>213</sup> Megjithkëtë, një zyrtar serb në Qeverinë e Kosovës argumenton se përderisa kjo zgjidhje rregullon disa probleme, përfundimisht "gjithçka varet nga gatishmëria e shoqërisë që të pranojë një zgjidhje të tillë, e cila për momentin, mendoj se nuk ekziston."<sup>214</sup>

Një gazetar i njohur pohon se shkëmbimi i territoreve duhet të ndodhë vetëm nëse miratohet nga SHBA dhe BE dhe duhet ta përjashtojë Mitrovicën e Veriut.<sup>215</sup> Një dallim i ngjashëm është bërë edhe nga një politikan kryesor i një partie opozitare, i cili promovon idenë e demarkacionit etnik të bazuar në kritere kadastrale.<sup>216</sup>

Megjithkëtë, disa të intervistuar argumentojnë se shkëmbimi i territoreve mund të diskutohet vetëm pas njohjes reciproke në mes të dy shteteve. Kjo duhet të ndodh për dy arsye: e para, në situatën aktuale, Kosova ndodhet në disavantazh, sepse Serbia kontrollon Luginën e Preshevës, por gjithashtu ka kontroll edhe në veriun e Kosovës.<sup>217</sup> E dyta, në konstelacionin ndërkombëtar, shkëmbimi territorial mund të ndodhë vetëm midis dy shteteve sovrane.<sup>218</sup> Në mënyrë alternative, një zgjidhje e tillë do të ishte pjesë e një pakoje më të gjerë për normalizimin e marrëdhënieve, e cila do të ishte rezultat i një konference të ndërmjetësuar ndërkombëtare dhe e aprovuar nga Këshilli i Sigurimit.

Duke përmbledhur disa nga pikat kyçe nga intervistat, rezulton se zbatimi i një skenari të tillë nga perspektiva e Kosovës çon në tri çështje komplekse. E para, mund të rrisë presionin në mes shqiptarëve të Kosovës për të kërkuar bashkimin me Shqipërinë, duke çuar kështu në shpërbërjen e shtetësisë së Kosovës. *E dyta*, duke qenë se Kosova veriore zotëron rezervat më të mëdha të ujit në Kosovë (Liqeni i Ujmanit/Gazivodës) si dhe pasuri të konsiderueshme minerare, atëherë shkëmbimi i territoreve do ta privojë atë nga këto pasuri. *E treta*, meqenëse shumica e serbëve jetojnë në jug të lumit Ibër, Kosova ende do të

---

<sup>213</sup> Intervista 71.

<sup>214</sup> Intervista 86.

<sup>215</sup> Intervista 15.

<sup>216</sup> Intervista 67.

<sup>217</sup> Intervista 11; Intervista 2; Intervista 52.

<sup>218</sup> Intervista 5; Intervista 21.

duhej t'i mbajë shumicën e dispozitave kushtetuese për të drejtat e pakicave, veçanërisht kur bëhet fjalë për parimin e "shumicës së dyfishtë", përfaqësimin politik, vetëqeverisjen lokale, si dhe mbrojtjen e monumenteve kulturore dhe fetare në Kosovë.

Nga të tre skenarët, është evidente që ky është skenari më i rrezikshëm, i papërshtatshëm për rrethanat ekzistuese dhe njëkohësisht më kompleks, megjithkëtë me disa mundësi potenciale për të zgjidhur konfliktin serbo-shqiptar. Por, ka të ngjarë që ky opsion të bëhet më atraktiv nëse zgjidhjet e tjera do të vërtetohen si të pamundura. Megjithkëtë, e vetmja mënyrë që një skenar i tillë të jetë i suksesshëm është miratimi i një pakoje përfundimtare në një konferencë ndërkombëtare dhe e aprovuar nga Këshilli i Sigurimit.

## 6. Përfundimet

Ky studim ka shtjelluar vazhdimësinë e dialogut, duke përfshi arritjet dhe dështimet, përgatitjet për fazën përfundimtare të tij, si dhe përvijimin e skenarëve eventual kryesor, dhe disa nën-variante. Përgjigjet e gjeneruara nga të intervistuarit dhe nga diskutimet në punëtori tregojnë se opinioni është i ndarë rreth çështjes së përfitimeve të Kosovës nga dialogu i tanishëm. Përderisa një shumicë e konsiderueshme mendon që Kosova ka shënuar arritje (ndonjëherë formale dhe simbolike) në lidhje me integrimin e serbëve të veriut në sistemin politik të Kosovës dhe ushtrimin e sovranitetit në këtë pjesë të territorit, të tjerët mendojnë që Serbia ka përfituar shumë më tepër, veçanërisht në rrugën e integritit në BE.

Gjithashtu, lidhur me përgatitjet për fazën e ardhshme, shumë nga të intervistuarit kritikojnë formatin aktual, mungesën e konsensusit politik si dhe mungesën e një strategjie dhe platforme të qartë negociuese. Në të njëjtën kohë, sugjerohet që Kosova, në prag të fazës përfundimtare të negociatave, është politikisht shumë e brishtë, e pa konsoliduar dhe e ndarë përbrenda. Kështu që, mënyra më e mirë për Kosovën që të rrisë fuqinë e saj negociuese është ndërtimi i kohezionit të brendshëm, koordinimi më i ngushtë me aleatët (SHBA-të në veçanti), këmbëngulja për një udhërrefyes dhe kornizë të qartë kohore, dhe, më e rëndësishmja, përfshirja më e gjerë në proces, me Kuvendin e Kosovës që do të luante një rol të rëndësishëm.

Përveç kësaj, një shumicë e konsiderueshme e të intervistuarve besojnë se Kosova nuk mund të bëjë ndonjë koncesione të mëtejshme që shkojnë përtej sistemit aktual ligjor dhe kushtetues. Në përgjithësi, nuk ka oreks për koncesione të mëtejshme dhe nuk mund të gjenden shumë udhëzime për koncesione të mëtejshme bazuar në shumicën e intervistave dhe punëtorive që janë organizuar/zhvilluar në muajt e fundit. Po ashtu, mund të konkludohet se çdo autonomi territoriale dhe politike për veriun e Kosovës do ta bënte Kosovën një shtet jofunksional dhe do të ishte vetëm si hap i parë drejt ndarjes së saj.

Sa i përket tre skenarëve, është e qartë mungesa e mbështetjes për vazhdimin e status quo-së, veçanërisht kur kemi parasysh kufizimet në përfitime për Kosovën si nga brenda ashtu

edhe nga jashtë; njohjet e kufizuara, mungesa e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare dhe ritmin e ngadalshëm të avancimit në integrimin në BE.

Deri tani, skenari më i mbështetur është ai i njohjes reciproke. Është argumentuar se Kosova duhet të insistojë në njohjen formale sepse vetëm në atë mënyrë Kosova mund ta përmbyllë shtetësinë e saj (duke përfshirë njohjen universale dhe anëtarësimin në OKB), të normalizojë marrëdhëniet me Serbinë, të integroj serbët lokalë në institucionet e saja dhe të punojnë së bashku drejt anëtarësimit në BE dhe NATO. Gjithashtu, njohja reciproke do të sigurojë një dialog më të gjerë shoqëror dhe pajtim, dhe njëkohësisht hap rrugën për zgjidhjen e çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me personat e pagjetur, kërkim faljen formale, çështjen e pronës e kështu me radhë.

Opinionin është më i ndarë, lidhur me nën-modalitetin tjetër të këtij skenari, i cili përfshin njohjen *de facto* përmes heqjes së Kosovës nga Kushtetuta e Serbisë (por pa njohje formale) me premtimin se Kosova do t'i bashkohet OKB-së. Një numër i të intervistuarve duket se e mbështesin këtë skenar, qoftë për shkakun e thjeshtë që është më i realizueshëm në rrethanat ekzistuese. Sipas sugjerimit të tyre, një modalitet i tillë do ta mbyllte çështjen e statusit përmes anëtarësimit eventual në OKB, si dhe çështjen e mosnjohjes nga 5 shtetet anëtare të BE-së. Në këmbim të kësaj, Kosova do të themelojë Asociacionin/Bashkësinë dhe do të gjejë mënyrën e rregullimit të çështjeve arsimore, shëndetësore dhe kulturore për pakicën serbe, me kusht që ato të mos shkojnë përtej dispozitave ekzistuese ligjore dhe të mos pengojnë funksionalitetin institucional të Kosovës dhe sovranitetin.

Nga ana tjetër, kundërshtarët e këtij modaliteti argumentojnë se çdo marrëveshje e cila nuk përfshin njohjen formale nga Serbia është e ndërlikuar dhe e rrezikshme, edhe nëse ajo parasheh ulëse në OKB. Është shumë e mundshme që anëtarësimi i Kosovës do të bllokohet nga Rusia (ose Kina) dhe, më e rëndësishmja, Serbia do ta përdorte këtë situatë për të vazhduar interferimin në punët e brendshme të Kosovës.

Skenari më ndarës dhe kontravers është skenari i tretë, i cili përfshin shkëmbimin territorial (veriu i Kosovës për Luginën e Preshevës). Përkundër potencialit të tij që të sjellë normalizim dhe paqe afatgjatë, shumëkush paralajmëron se një skenar i tillë më shumë do ta destabilizonte rajonin, dhe do të kishte implikime negative ekonomike

(Ujmani/Gazivoda), ose mund të çojë në humbjen e shtetësisë së Kosovës (në rast të bashkimit me Shqipërinë). Megjithkëtë, duhet theksuar, se nëse ky skenar do të ketë mbështetje më të gjerë ndërkombëtare dhe në një farë mase të kënaqë të dyja palët, atëherë mund të provohej si një zgjidhje e mundshme afatgjate, në rast se opsionet e tjera nuk do të provoheshin të realizueshme.

Të tre skenarët, duke përfshirë argumentet pro dhe kundër janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, që bazohen në komentet/inputin e gjeneruar nga të intervistuarit:

Skenarët	Pros bazuar në ata që argumentuan në favor të këtij skenari	Kundërshtimet bazuar në ata që argumentuan kundër këtij skenari
I(a): Pa dialog	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mund të mos i mundësoj Serbisë përparësi maksimale për të avancuar në rrugën e saj drejtë integrimit në BE, duke përdorur dialogun me Kosovën si një mjet.</li> <li>➤ I jep kohë Kosovës për të definuar dhe rishikuar interesat dhe qëllimet e saj.</li> <li>➤ Zhvendos fokusin nga dialogu dypalësh në një dialog të brendshëm në mes të Shqiptarëve dhe Serbëve në Kosovë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Parandalon integrimin e Serbëve lokal.</li> <li>➤ Kontribon në destabilizimin rajonal.</li> <li>➤ Parandalon njohjen universale dhe anëtarësimin në OKB.</li> <li>➤ Mban perspektivën e Kosovës për në BE në harresë.</li> <li>➤ Rrezikon të kthejë Kosovën në një 'konflikt të ngrirë'.</li> <li>➤ Kosova rrezikon izolimin ndërkombëtar. Ngecjen e marrëdhënieve me aktorë ndërkombëtar.</li> <li>➤ Mund të dëmtoj marrëdhëniet ndër-etnike, dhe të prolongoj procesin e pajtimit.</li> <li>➤ Nëse Kosova ndërpret dialogun, mund të mos ketë përkrahje institucionale nga BE-ja në zbatimin e MSA-së.</li> <li>➤ Mund të jetë pengesë për njohje të mëtejshme, integrim në institucionet Euro- Atlantike, dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare.</li> <li>➤ Ndërprerja e dialogut parandalon të Kosovën dhe Serbinë në rrugën e tyre drejt integrimit Evropian.</li> <li>➤ Stagnimi i dialogut mund të rris influencën e Rusisë në rajon.</li> </ul>



<p><b>I(b): Vazhdimi i Status kuo-së (dialogu teknik)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mund të ofroj kohë për Kosovën të reflektoj në dialog dhe arritjet e deritanishme.</li> <li>➤ Mund të kontribuoj në përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe në mes të Kosovës dhe Serbisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Lejon Serbinë të ndërhyjë në Kosovë duke avancuar kështu në agjendën e saj drejt BE-së.</li> <li>➤ Nëse dialogu ndërpritet ose shtyhet, Kosova humb mundësinë të zgjidh çështjet dypalëshe që duhet të adresohen si çështje emergjente.</li> <li>➤ Status kuo mund të ndikojë negativisht në zbatimin e të gjitha marrëveshjeve që janë arritur/nënshkruar deri tani.</li> </ul>
<p><b>II(a): Njohja reciproke</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mundëson normalizim të plotë.</li> <li>➤ Mundëson njohjen universale të Kosovës dhe anëtarësimin në OKB.</li> <li>➤ Stabilizon rajonin.</li> <li>➤ Përshpejton procesin e integritimit në BE.</li> <li>➤ Përmirëson marrëdhëniet ndër-etnike, dhe siguron integritimin e Serbëve lokal.</li> <li>➤ Lehtëson integritimin në BE dhe NATO për tërë rajonin.</li> <li>➤ Hap rrugën për pajtim.</li> <li>➤ Hap rrugën për marrëveshje tjera eventuale rreth pensioneve, personave të zhdukur, pronës etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Nëse Asociacioni/Bashkësia me kompetenca ekzekutive do të jetë pjesë e kësaj marrëveshje eventuale, Kosova rrezikon jofunksionalitetin politik afatgjatë.</li> <li>➤ Ndërhyrje eventuale në aranzhimet kushtetuese të Kosovës.</li> <li>➤ Rrezik për krijimin e një entiteti autonom Serb në këmbim të njohjes.</li> </ul>
<p><b>II(b): Nënshkrimi i marrëveshjes ligjërish të detyrueshme, por jo njohje formale</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Serbia njih kornizën/sistemin e veçantë ligjor të Kosovës.</li> <li>➤ Mund të ndikojë pozitivisht në 5 vendet mos-njohëse të BE-së.</li> <li>➤ Lehtëson rrugën e të dy shteteve në rrugën e tyre drejt</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Nuk garanton automatikisht ulësen në OKB dhe njohjen universale.</li> <li>➤ I mundëson Serbisë të minojë shtetësinë e Kosovës nga brenda përmes kontrollit të Asosacionit/Komunitetit dhe Listës Serbe.</li> <li>➤ Rrezikon rihapjen e statusit dhe çështjen e kufinjve në të ardhmën.</li> </ul>

	<p>integritit në BE.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Ka ndikim pozitiv rajonal.</li> <li>➤ I mundëson Kosovës të fokusohet në çështje të tjera të rëndësishme, siç janë çështjet/problemet ekonomike.</li> <li>➤ Rrit nivelin e integritit të Serbëve lokal në institucionet e Kosovës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Anëtarësimi në OKB varet nga Rusia dhe Kina. Anëtarësimi është i pavarur nga dialogu me Serbinë.</li> <li>➤ Kosova rrezikon të kthehet në një shtet jofunksional, për shkak të ndërtimit strukturor të brendshëm.</li> <li>➤ Situata aktuale ndërkombëtare tregon se anëtarësimi potencial i Kosovës mund të përballlet me sfida në ndërtimin e konsensusit ndërkombëtarë.</li> <li>➤ Anëtarësimi nuk siguron normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë. Kosovës i duhet njohja formale nga Serbia për normalizim të plotë. Në aspektin afatgjatë një zgjidhje pa njohje formale mund të mos prodhoj përfitime.</li> <li>➤ Rusia ka përdorur fuqinë e vetos në më shumë se 60% të rasteve të ndryshme në OKB; është shumë e mundshme që do ta përdorin edhe në rastin e Kosovës. Dhe ideja e kushtëzimit të dialogut me një anëtarësim potencial në OKB mund të jetë shumë ambicioze.</li> </ul>
<p>III: (Ri)rregullimi i kufijve (shkëmbimi territorial)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mund të krijojë parakushte për një normalizim të plotë të marrëdhënieve.</li> <li>➤ Mund të interpretohet si një lehtësim për Kosovën nga barra e territorit (të padisiplinuar) duke forcuar kështu sovranitetin e saj.</li> <li>➤ Mund të marrë mbështetjen e të dyja popullatave (serbët në veri të Kosovës dhe shqiptarët në Luginën e Preshevës).</li> <li>➤ Mund të jetë një zgjidhje praktike në qoftë se vjen me një marrëveshje mbi Trepçën dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Rrezikon që të shkakton një reaksion zinxhir në rajon.</li> <li>➤ Mund të përtërijë konfliktet rajonale.</li> <li>➤ Paraqet një fitore të vizionit nationalist të viteve 1990, krijimin e shteteve mono-etnike - diçka kundër vlerave perëndimore.</li> <li>➤ Nuk do të zgjidhë çështjen e serbëve që jetojnë në jug të lumit Ibër.</li> <li>➤ Privon Kosovën nga burimet e rëndësishme natyrore (Ujmani/Gazivoda, Trepça).</li> <li>➤ Mund të iniciojë përleshjet e brendshme, aktorë të ndryshëm politikë mund të kundërshtojnë idenë, si dhe të kenë mendime kontradiktore.</li> <li>➤ Do të ishte sfiduese që Kosova të bëjë që Serbia të heqë dorë nga</li> </ul>

	<p>Ujmanin/Gazidovën.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Nuk duhet të përjashtohet asnjë mundësi, për sa kohë që Serbia dhe Kosova pajtohen, veçanërisht nëse opsione të tjera nuk do të rezultonin të realizueshme.</li> </ul>	<p>pushteti mbi Luginën e Preshevës. Serbia kontrollon Luginën e Preshevës dhe në një masë të madhe edhe veriun e Kosovës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Demonstron paaftësinë e Kosovës për të gjetur zgjidhje të arsyeshme dhe në vend të kësaj për zgjidhje që nuk mund të avancohen.</li> <li>➤ Kosova është një vend multietnik, prandaj do të ishte sfiduese për të promovuar një bashkësi të vetme etnike.</li> <li>➤ Kompromisi dhe pëlqimi i Serbisë nuk është i garantuar.</li> <li>➤ Efektet kundërproduktive, Serbia mund të kërkojë më shumë nga Kosova në këmbim të Luginës së Preshevës.</li> <li>➤ Ka shumë të ngjarë që komuniteti ndërkombëtar të jetë negativ për një zgjidhje të tillë.</li> </ul>
--	---	---

**Tabela 2. Skenarët – Avantazhet dhe Disavantazhet**

## 7. Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme bazohen në diskutimet në intervistat dhe punëtoritë e realizuara/mbajtura për qëllimet e këtij studimi:

- Kosova duhet të angazhohet për këtë dialog dhe ta shfrytëzojë këtë mundësi për të zgjidhur të gjitha çështjet dypalëshe me Serbinë, për të dëshmuar dëshirën e saj për marrëdhënie të mira fqinjësore dhe për një perspektivë progresive Euro-atlantike.
- Kosova duhet të kërkojë një marrëveshje të normalizimit të plotë dhe njohjes reciproke me Serbinë. Institucionet e Kosovës duhet të jenë të vetëdijshme se anëtarësimi në OKB nuk ka të ngjarë të garantohet në këto negociata, e aq më pak në formatin aktual.
- Është e këshillueshme që institucionet e Kosovës të shmangin/të mos ndjekin skenarin e parë dhe të tretë të identifikuar në këtë studim dhe përpjekja e tyre duhet të jetë e orientuar për skenarin e dytë, me preferencë për variantin e parë.

- Pavarësisht se cili skenar do të ndiqet, Qeveria e Kosovës duhet të fillojë një rishikim të marrëveshjeve ekzistuese për të përcaktuar rrugën për të siguruar zbatimin e tyre dhe të nxjerr mësim nga to për çdo negociatë të ardhshme. Procesi i shqyrtimit duhet të zhvillohet në mënyrë transparente, duhet të përfshijë të gjithë akterët kryesor institucional dhe të shoqërisë civile dhe mundësisht të përfundojë përpara se dialogu i ri të hyjë në fazën përfundimtare.

- Institucionet e Kosovës duhet të kërkojnë të ndërtojnë një konsensus më të gjerë politik dhe shoqëror dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme parlamentare. Kjo mund të bëhet përmes tre mekanizmave: i pari mund të marrë formën e një ekipi të përbërë nga partitë dhe interesat e ndryshme politike, duke përfshirë shoqërinë civile dhe botën akademike; i dyti duhet të përbëhet nga Kuvendi i Kosovës (duke përfshirë komisionet relevante); dhe i treti një zyrë teknike dhe koordinuese në zyrën e Kryeministrit, e cila do të mbulonte zbatimin e marrëveshjeve.

- Duke pasur parasysh kohën disi të kufizuar në dispozicion përpara fillimit të fazës së re të dialogut, institucionet e Kosovës duhet të iniciojnë një proces konsultimi të gjerë politik dhe publik me qëllim të miratimit të një mandati dhe një strukture për ekipin negociues dhe platformës, gjithashtu.

- Liderët e Kosovës duhet të insistojnë që faza përfundimtare e dialogut duhet të ketë një afat kohor të qartë dhe duhet të rezultojë në një marrëveshje përfundimtare që është ligjërish e detyrueshme dhe e jo e dykuptimtë.

- Institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë që dialogu të mos anashkalojë aspekte të tjera të reformës institucionale (në arsim, shëndetësi, ekonomi, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, etj.) dhe procesin e shtet-ndërtimit, të cilat duhet të vazhdojnë paralelisht me dialogun.

- Çdo marrëveshje përfundimtare duhet të diskutohet në publik dhe në Kuvend dhe të miratohet nga Kuvendi i Kosovës në përputhje me procedurat kushtetuese (me fjalë të tjera, me shumicë prej 2/3).
- Qeveria e Kosovës duhet të intensifikoj një dialog të brendshëm dhe shoqëror me serbët vendas (përfaqësuesit, udhëheqësit e komunitetit, dhe shoqërinë civile) së bashku me dialogun ndërqeveritar me Serbinë si një mënyrë për integrimin dhe fuqizimin e serbëve lokalë të Kosovës.

## Shtojca: Pyetëtori

# SKENARËT E DIALOGUT DHE MARRËVESHJES EVENTUALE FINALE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

**Vërejtje:** Ju lutem vini re se pyetjet e mëposhtme janë indikative dhe kanë për qëllim të sigurojnë bazën e një diskutimi jo-formal. Ne nuk supozojmë se të intervistuarit do të jenë në gjendje t'i përgjigjen të gjitha pyetjeve. Përgjigjet e të intervistuarve nëse kërkohet do të jenë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për këtë studim.

1. Cili ka qenë efekti i dialogut në (perzgjedh sipas nevojës):
  - a) Shtirje të sovranitetit në veri dhe integrim të serbëve në Kosovë;
  - b) Në avancimin e agjendës europiane të Kosovës;
  - c) Nënjuhjen e mëtejshme ndërkombëtare të Kosovës dhe anëtarësimin e Kosovës në organizata rajonale e ndërkombëtare;
  - d) Në zhvillimin ekonomik të vendit.
2. Çfarë ka arritur Kosova nëpërmjet dialogut të Brukselit? Duke pasur parasysh arritjet dhe stagnimin në dialogun aktual, a mendoni se ka pasur ndonjë alternativë tjetër? Nëse po, cila alternativë?
3. Cilat do të ishin pasojat nga ndërprerja eventuale e dialogut?
4. Si të organizohet dialogu i ri? A mendoni se duhet ndryshuar formati i dialogut dhe qasja e Kosovës ndaj dialogut?
5. Çfarë formati duhet të ketë faza e ardhshme (finale) e dialogut dhe cilat duhet të jenë objektivat e tij?
6. A është dialogu i brendshëm me serbët lokalë zëvendësim për dialogun me Serbinë?
7. A nevojitet përfshirje më e gjerë e spektrit politik (opozitës), shoqërisë civile, biznesit dhe grupeve të tjera të interesit në dialog? Nëse po, kush duhet të përfshihet, çfarë struktura, etj?
8. Cilat mendoni se duhet të jenë vijat e kuqe të Kosovës në fazën e re të dialogut?
9. A mund dhe a duhet Kosova të bëjë koncesione të tjera sa i përket autonomisë së serbëve në Kosovë, pronës shtetërore dhe shoqërore të ish Jugosllavisë, monumenteve kulturore etj. në shkëmbim për një marrëveshje finale që i mundëson Kosovës anëtarësimin në OKB?

10. A duhet që Kosova të kushtëzojë çfarëdo marrëveshje të re me Serbinë me dëmshpërblim për dëmet e luftës dhe kthim të trupave të personave të zhdukur? Çfarë kushtëzimesh tjera duhet të vendos Kosova?
11. Çfarë zgjidhje duhet të ofrojë Kosova për çështjen e sistemit arsimor dhe shëndetësor të Serbisë në Kosovë? Çka mund të ofroj tjetër Kosova për serbët, si pjesë e vullentit të mirë, pa e dëmtuar funksionalitetin dhe sovranitetin e vendit?
12. A mund dhe a duhet që Kosova të kërkojë më shumë të drejta për shqiptarët në Luginë të Preshevës në këmbim për autonomi të zgjeruar (kompetenca ekzekutive për AKS) për serbët në Kosovë?
13. A është ndryshimi i kufijve (këmbimi i veriut me Luginën e Preshevës ose bashkim i veriut me Serbinë) opsion i realizueshëm dhe i pranueshëm për Kosovën në këmbim të njohjes nga Serbia?
14. Në rast të hapjes së çështjes së ndryshimit të kufijve, a duhet që Kosova të kërkojë bashkimin me Shqipërinë?
15. A ka ndonjë skenar apo model tjetër të realizueshëm që mund të dalë nga dialogu me Serbinë?
16. Në këto rrethana çfarë mund të jetë kompromisi i mundshëm mes Kosovës e Serbisë? Mendo për një moment dhe më jep një skenar të drejt që mund të ishte kompromis i pranueshëm për shqiptaret dhe serbët?
17. A keni ndonjë ide apo sugjerim shtesë rreth kësaj teme?
18. A mund të ju referohemi/citojmë me emër dhe mbiemër apo vetëm si zyrtar i institucionit që përfaqësoni?



[www.ridea-ks.org](http://www.ridea-ks.org)



[www.balkansgroup.org](http://www.balkansgroup.org)